Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
*Komisioni Qendror i Zgjedhjeve*
*Centralna Izborna Komisija*
*Central Election Commission*

# RAPORTI I PUNËS
# I KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE
# PËR VITIN 2016

Prill, 2017

## FJALA E KRYETARES SË KQZ-së

***I nderuari Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Kadri Veseli,***

***Të nderuar deputetë,***

**Më lejoni që në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke u bazuar në obligimin e përcaktuar në nenin 63.10 të Ligjit Nr. 03/L073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, t'i paraqes Kuvendit të Republikës së Kosovës: Raportin e Punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2016.**

*Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, si institucion i pavarur, ka rolin e vet në hapësirën institucionale për të forcuar demokracinë përmes zgjedhjeve dhe ne mbesim të përkushtuar në përmbushjen e qëllimit tonë që zgjedhjet të gëzojnë besimin e qytetarëve dhe të akterëve të tjerë zgjedhor.*

*Ky Raport, është një pasqyrim i aktiviteteve dhe punës sonë, duke përfshirë edhe bashkëpunimin brenda dhe jashtë vendit. Raporti i punës për vitin 2016, tregon përpjekjet e vazhdueshme të KQZ-së për të qenë çdo herë një institucion i besueshëm dhe profesionalisht i përgatitur në përmbushjen e detyrimeve, kushtetuese dhe ligjore.*

*Komsioni Qendror i Zgjedhjeve përmbylli vitin 2016 me një sukses të jashtëzakonshëm. Arritëm të bëhemi anëtari i 25-të institucional, me të drejta të plota, i Asociacionit të Zyrtarëve Zgjedhor Europian (ACEEEO). Ky asociacion, që përmes konferencave vjetore adreson shumëllojshmëri të temave me të cilat përballen Trupat Menaxhuese të Zgjedhjeve, do të jetë një hapësirë e çmuar për KQZ-në për të marrë mësime dhe për të dhënë kontributin e vet.*

*KQZ-ja është në rrugëtim të mbarë dhe arritjet e këtij viti do të jenë një mundësi e jashtëzakonshme në zhvillimin e mëtejshëm të institucionit.*

*Ndërtimi dhe zbatimi i praktikave të mira zgjedhore, promovimi dhe pjesëmarrja në ngjarjet ndërkombëtare të karakterit zgjedhor, ngritja e transparencës dhe e besueshmërisë, realizimi me integritet i proceseve zgjedhore, rritja e pjesëmarrjes së votuesve në zgjedhje, modernizimi dhe efikasiteti i shërbimeve, etj., do të jenë synime të përditshme të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.*

*Mund të konstatojmë se përvoja e deritanishme zgjedhore, forcimi i kapaciteteve tona të brendshme në përmbushjen e veprimtarisë, duke bashkëpunuar me institucione brenda vendit dhe me organizata ndërkombëtare në fushën e zgjedhjeve, janë një garanci e profesionalizmit të KQZ-së. Ky aspekt na mundëson ndërtimin e kapaciteteve të duhura zgjedhore, ashtu si edhe plotësimin e sigurt të standardeve ndërkombëtare.*

***Valdete Daka***

***Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve***

## LISTA E SHKURTESAVE

| | |
|---|---|
| **ACEEEO** | Asociacioni i Zyrtarëve Zgjedhorë Evropianë |
| **A-ËEB** | Asociacionit të Trupave Zgjedhore Botërore |
| **BE** | Bashkimi Evropian |
| **DPA** | Departamenti i Prodhimit të Dokumenteve |
| **FPR** | Formulari i Përputhjes se të Dhënave dhe Rezultateve |
| **FRK** | Formulari i Rezultateve të Kandidatëve |
| **IFES** | Fondacioni Ndërkombëtar për Sistemet Zgjedhore |
| **KPK** | Këshilli Prokurorial i Kosovës |
| **KKZ** | Komisionet Komunale të Zgjedhjeve |
| **KVV** | Këshillat e Vendvotimeve |
| **KQZ** | Komisioni Qendror i Zgjedhjeve |
| **LV** | Lista Votuese |
| **MAP** | Ministria e Administratës Publike |
| **MAPL** | Ministria e Administratës dhe e Pushtetit Lokal |
| **MD** | Ministria e Drejtësisë |
| **MF** | Ministria e Financave |
| **MIE** | Ministria e Integrimeve Evropiane |
| **MPB** | Ministria e Punëve të Brendshme |
| **MPJ** | Ministria e Punëve të Jashtme |
| **MSH** | Ministria e Shëndetësisë |
| **OJQ** | Organizatat Joqeveritare |
| **OSCE** | Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian |
| **PZAP** | Paneli Zgjedhor për Parashtresa dhe Ankesa |
| **QNR** | Qendra e Numërimit dhe Rezultateve |
| **QV** | Qendra e Votimit |
| **SKQZ** | Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve |
| **SHV** | Shërbimi Votues |
| **VV** | Vendvotimet |
| **ZFK** | Zarfi i Fletëvotimit me Kusht |
| **ZRPP** | Zyra për Regjistrim të Partive Politike |

## LISTA E TABELAVE

**TABELA 1:** STRUKTURA KUALIFIKUESE E STAFIT TË SKQZ-SË ..... 13
**TABELA 2:** STRUKTURA ETNIKE E STAFIT TË SKQZ-SË ..... 13
**TABELA 3:** STRUKTURA GJINORE E STAFIT TË SKQZ-SË ..... 13
**TABELA 4**: LISTA E TRAJNIMEVE PËR VITIN 2016 ..... 14
**TABELA 5:** PËRMBLEDHJA E PASURIVE JO-FINANCIARE KAPITALE (ME VLERË MBI 1000 EURO) NË POSEDIM TË KQZ-SË ..... 15
**TABELA 6:** LISTA E PARTIVE POLITIKE TË PEZULLUARA DHE LISTA E PARTIVE POLITIKE PAS LARGIMIT TË MASËS SË PEZULLIMIT ..... 16
**TABELA 7**: LISTA E PARTIVE POLITIKE TË ÇREGJISTRUARA (2016) ..... 17
**TABELA 8:** LISTA E PARTIVE POLITIKE TË GJOBITURA PËR VONESË NË DORËZIMIN E AZHURNIMEVE 2015 ..... 17
**TABELA 9:** LISTA E PARTIVE POLITIKE TË REGJISTRUARA MË 2016 ..... 17
**TABELA 10:** LISTA E KUVENDEVE TË PARTIVE POLITIKE TË MONITORUARA GJATË VITIT 2016 ..... 18
**TABELA 11:** TRAJNIMET DHE TAKIMET E MBAJTURA NGA ZRPPC ..... 19
**TABELA 12:** PARAQITJA E NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË VOTUESVE PËR ZGJEDHJET 2014 E PARAQITUR PËR ÇDO KOMUNË, NUMRI I VOTUESVE QË KANË VOTUAR NË VENDVOTIME, NUMRIT TË VOTUESVE QË KANË VOTUAR ME KUSHT DHE PËRQINDJA E VOTUESVE QË KANË VOTUAR ME KUSHT NË RAPORT ME DALJEN NË VOTIME ..... 20
**TABELA 13:** PARAQITJA TABELARE E QENDRAVE TË REJA TË VOTIMIT PËR SECILËN KOMUNË ..... 21
**TABELA 14**: SUBJEKTET POLITIKE TË CERTIFIKUARA PËR PJESËMARRJE NË ZGJEDHJE (GLLOGOC). ..... 32
**TABELA 15:** EMËRIMI I KKZ-VE DHE KVV-VE PËR ZGJEDHJET E JASHTËZAKONSHME PËR KRYETAR KOMUNE NË GLLOGOC ..... 34
**TABELA 16:** NUMRI I PËRGJITHSHËM I VËZHGUESVE TË AKREDITUAR PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE NË GLLOGOC ..... 35
**TABELA 17:** REZULTATET PËRFUNDIMTARE TË TË DY RAUNDEVE TË ZGJEDHJEVE PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË GLLOGOCIT ..... 36
**TABELA 18:** AUDIENCA SIPAS SHTETEVE ..... 36
**TABELA 19:** BUXHETI I PLANIFIKUAR DHE SHPENZUAR PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2016 ..... 38
**TABELA 20:** BUXHETI I PLANIFIKUAR PËR SUBJEKTET POLITIKE DHE SHPËRNDARJA PËR VITIN 2016 ..... 40
**TABELA 21:** BUXHETI I PLANIFIKUAR PËR GRUPET PARLAMENTARE DHE PAGESAT PËR VITIN 2016 ..... 41
**TABELA 22:** OBLIGIMET E PAPAGUARA PËR VITIN 2016 TË KQZ-SË TË BARTURA NË VITIN 2017 ..... 42
**TABELA 23:** AKTIVITETET E PROKURIMIT ..... 44

## LISTA E FIGURAVE

**FIGURA 1:** PARAQITJA GRAFIKE E BUXHETIT TË PLANIFIKUAR DHE SHPENZUAR PËR VITIN 2016. ..... 39

# PASQYRË E HOLLËSISHME E PËRMBAJTJES


**FJALA E KRYETARES SË KQZ-SË** ..... **1**

**LISTA E SHKURTESAVE** ..... **3**

**LISTA E TABELAVE** ..... **4**

**LISTA E FIGURAVE** ..... **4**

**PASQYRË E HOLLËSISHME E PËRMBAJTJES** ..... **5**

**1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE** ..... **8**

**2. KORNIZA LIGJORE** ..... **9**

**3. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT** ..... **10**

3.1. MISIONI ..... 10

3.2. VIZIONI ..... 10

3.3. KOMPETENCAT E KQZ-SË ..... 10

**4. FUSHËVEPRIMI QË E MBULON INSTITUCIONI** ..... **11**

4.1. MANDATI I KQZ-SË ..... 11

4.2. PËRGJEGJËSITË ..... 11

4.3. PËRBËRJA E KQZ-SË ..... 12

4.4. KËSHILLAT E KQZ-SË ..... 12

4.5. STRUKTURA DHE ORGANIZIMI I SEKRETARIATIT TË KQZ-SË (SKQZ) ..... 13

4.6. ZYRA PËR REGJISTRIMIN E PARTIVE POLITIKE DHE CERTIFIKIM (ZRPPC) ..... 13

4.7. KOMISIONET KOMUNALE TË ZGJEDHJEVE (KKZ) ..... 13

4.8. BURIMET NJERËZORE ..... 13

*4.8.1. Trajnimi i stafit* ..... *14*

4.9. ASETET E INSTITUCIONIT ..... 15

**5. AKTIVITETET PËR PERIUDHËN RAPORTUESE** ..... **16**

5.1. AKTIVITETET SIPAS PLANIT TË PUNËS ..... 16

*5.1.1. Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim (ZRPPC)* ..... *16*

5.1.1.1. Azhurnimi vjetor i të dhënave të partive politike ..... 16

5.1.1.2. Regjistrimi i Partive Politike ..... 17

5.1.1.3. Pranimi i Raporteve Vjetore Financiare ..... 18

5.1.1.4. Monitorimi i Kuvendeve të Partive Politike ..... 18

5.1.1.5. Takimet me përfaqësues të Subjekteve Politike dhe trajnimet e përfaqësuesve financiar të tyre ..... 18

*5.1.2. Shërbimi i votuesve* ..... *19*

5.1.2.1. Analizë e krijimit të Listës së Votuesve dhe Votave me Kusht për Zgjedhjet 2014 ..... 19

5.1.2.2. Themelimi i Qendrave të Reja të Votimit ..... 20

5.1.2.3. Analizë lidhur me zbatimin e projektit për votuesit e verbër dhe me të pamur të dobësuar ..... 21

5.1.2.4. Përmirësimi dhe Qëndrueshmëria e Listës së Votuesve: Vendbanimi im, vendvotimi im ..... 22

5.1.2.5. Aktivitetet e grupit punues KQZ – MPB për përmirësimin e Listës së Votuesve ..... 22

5.1.2.6. Krijimi për nevoja të brendshme i një harte/pasqyre gjeografike për ecurinë e zgjedhjeve ..... 23

*5.1.3. Programi i trajnimit* ..... *23*

5.1.3.1. Certifikimi i anëtarëve të Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve ..... 23

5.1.3.2. Atributet dhe aktivitetet për zbatimin e programit ..... 24

*5.1.4. Teknologjia Informative në zgjedhje* ..... *24*

5.1.4.1. Inovacioni dhe teknologjia ..... 25
5.1.4.2. Platforma hartografike digjitale ..... 25
5.1.4.3. Platforma për modernizimin e operacioneve zgjedhore ..... 25
5.1.4.4. Zhvillimi i Platformës për Monitorim të Shkeljeve në Zgjedhje ..... 27
*5.1.5. Informimi publik ..... 27*
*5.1.5.1. Informimi dhe Edukimi i Votuesve të Rinj për Zgjedhje ..... 27*
*5.1.5.2. Dita Globale e Zgjedhjeve ..... 28*
*5.1.6. Vendimet dhe mbledhjet e KQZ-së ..... 28*
5.2. BASHKËPUNIMI BRENDA – JASHTË VENDIT DHE VËZHGIMI I ZGJEDHJEVE ..... 28
*5.2.1. Anëtarësimi i KQZ-së në ACEEEO ..... 29*
5.2.1.1. KQZ dhe ACEEEO me Memorandum Bashkëpunimi ..... 29
5.2.1.2. Vizita e KQZ-së së Shqipërisë pas anëtarësimit në ACEEEO ..... 29
*5.2.2. <Gratë në menaxhimin zgjedhor> ..... 30*
*5.2.3. KQZ-ja zgjedhet anëtare e Komitetit të Auditimit dhe Mbikëqyrjes të A-ËEB'it ..... 30*
*5.2.4. Memorandum Bashkëpunimi: KQZ – PZAP – PK – PSh – KGjK ..... 30*
*5.2.5. Grupi për Qasje në Zgjedhje ..... 30*
*5.2.6. Aktivitetet me Kuvendet Komunale ..... 31*
*5.2.7. Pjesëmarrja në konferenca dhe vëzhgimi i zgjedhjeve ..... 31*
5.2.7.1. Pjesëmarrja në Konferenca Ndërkombëtare ..... 31
5.2.7.2 Vëzhgimi i Zgjedhjeve ..... 31
5.3. ORGANIZIMI I ZGJEDHJEVE TË JASHTËZAKONSHME PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË GLLOGOCIT ..... 32
*5.3.1. Miratimi i Planit Operacional ..... 32*
*5.3.2. Certifikimi i Subjekteve Politike dhe Kandidatëve ..... 32*
*5.3.3. Kufizimi i shpenzimeve dhe raportimi financiar i fushatës zgjedhore ..... 33*
*5.3.4. Lista Përfundimtare e Votuesve ..... 33*
*5.3.5. Informimi publik për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Gllogoc ..... 33*
*5.3.6. Emërimi i KKZ-ve dhe KVV-ve ..... 34*
*5.3.7. Trajnimi i trupave zgjedhore për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Gllogoc ..... 34*
*5.3.8. Akreditimi i Vëzhguesve ..... 35*
*5.3.9. Dita e Zgjedhjeve ..... 35*
*5.3.10. Numërimi, tabulimi dhe publikimi i rezultateve ..... 35*
5.3.10.1. Publikimi i Rezultateve Preleminare (K – Vote) ..... 36
5.3.10.2. Audienca dhe shikueshmëria e ueb faqes së rezultateve ..... 36

**6. BUXHETI DHE FINANCAT ..... 37**
6.1. APROVIMI I BUXHETIT ..... 37
6.2. RISHIKIMI I BUXHETIT ..... 37
6.3. BUXHETI SHTESË ..... 37
6.4. PAGA DHE MËDITJE ..... 39
6.5. MALLRAT DHE SHËRBIMET ..... 40
6.6. SHPENZIMET KOMUNALE ..... 40
6.7. SUBVENCIONE DHE TRANSFERE ..... 40
6.8. SHPENZIMET KAPITALE ..... 41
6.9. TË HYRAT VETANAKE ..... 41
6.10. GRANDET DHE NDIHMAT ..... 41
6.11. OBLIGIMET E PAPAGUARA ..... 41
6.12. AKTIVITETET TJERA ..... 42

**7. PROKURIMI** ..... **43**

**8. AUDITIMI I BRENDSHËM** ..... **45**

**9. SFIDAT DHE REKOMANDIMET** ..... **46**

9.1. SFIDAT ..... 46

9.2. REKOMANDIMET ..... 47

**SHTOJCAT** ..... **48**

SHTOJCA 1 – ORGANOGRAMI I KQZ-SË ..... 49

SHTOJCA 2 – RAPORTI FINANCIAR ..... 50

# 1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në pajtim me obligimet që dalin me nenin 63.10 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Lokale në Republikën e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), paraqet këtë informatë për Raportin e Punës për Kuvendin e Republikës së Kosovës, me qëllim të pasqyrimit të të gjitha aktiviteteve të zhvilluara për periudhën njëvjeçare (2016), duke dëshmuar rolin dhe përgjegjësitë që ka me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Lokale.

Raporti paraqet informacione përmbajtjesore lidhur me aktivitetet e ndërmarra nga KQZ-ja, që kanë për qëllim arritjen e prioriteteve, objektivave dhe qëllimeve strategjike, që janë përcaktuar me ligjet burimore, Planin Strategjik 2015-2018 dhe Planin Vjetor të Punës 2016. Po ashtu, në raport është bashkangjitur Raporti financiar si dhe veprimet e ndërmarra për gjetjet dhe rekomandimet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin paraprak.

Meqenëse, në vitin 2016 janë mbajtur Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Gllogocit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve brenda përgjegjësive kushtetuese e ligjore dhe në përputhje me vendimin e Presidentit, ka organizuar dhe administruar këto zgjedhje të mbajtura me 4 dhjetor 2016 (raundi i parë) dhe më 18 dhjetor 2016 (raundi i dytë).

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i cili po fuqizohet çdo ditë e më shumë, ka arritur të certifikoi rreth 600 persona, anëtarë të Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve. Qëllimi i këtij programi është që të krijohet një mekanizëm i avancuar profesional ndërmjet KQZ-së dhe Subjekteve Politike gjatë ushtrimit të mandatit të anëtarëve të KKZ-ve. Personat e pajisur me certifikata mund të konsiderohen si kandidat potencial për të qenë anëtarë të Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve gjatë proceseve zgjedhore. Ky program, synohet që të jetë i përhershëm gjatë viteve jo zgjedhore.

Themelimi i 91 qendrave të reja të votimit, ka qenë objektivi më i rëndësishëm i KQZ-së, që është paraparë në Planin e Punës për vitin 2016. Ky aktivitet i ndërmarrë nga ana e KQZ-së ka për qëllim që qytetarëve me të drejtë vote t'iu ofrojë mundësinë që të votojnë më afër vendbanimit të tyre.

Hartimi i Planit të Punës për vitin 2016 dhe implementimi i tij në shumë aktivitete, ka rezultuar në përmirësimin e disa aspekteve të rëndësishme për proceset zgjedhore. Në Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komunë në Gllogoc, KQZ-ja për herë të parë ka përdorur teknologjinë informative për një aspekt të procesit zgjedhor, siç është përdorimi i aplikacionit online për ndërrimin e qendrave të votimit.

Në këtë plan, KQZ-ja ka përkufizuar qartazi vizionin dhe misionin e saj, sikurse edhe orientimet. KQZ-ja, në kuadër të përgjegjësive të veta ligjore, gjatë vitit 2016 ka arritur t'i realizojë shumicën e objektivave të parapara me Planin e Punës.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka arritur ta përmbyllë suksesshëm vitin 2016 pasi ka arritur të anëtarësohet në Asociacionin e Zyrtarëve Zgjedhorë Europian (ACEEEO), nga ku do të mund të përfitojë në të ardhmen duke marrë pjesë në programe në lidhje me administrimin e zgjedhjeve.

## 2. KORNIZA LIGJORE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organ i përhershëm dhe i pavarur, i përcaktuar me nenin 139 të Kushtetutës së Republikës se Kosovës.

Baza e funksionimit të KQZ-së mbështetet në këto ligje: Ligji nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme (05 qershor 2008), i ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-256 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës; Ligjin nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale (29 tetor 2010); dhe Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike Nr. 03/L-174 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-058, i ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-212.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me qëllim të operacionalizmit të fushëveprimtarisë së vet ka miratuar deri më tani 17 Rregulla Zgjedhore, ndërsa vetëm gjatë vitit 2016, ka miratuar akte të brendshme nënligjore (dy Rregulla Zgjedhore dhe një Udhëzues) të cilat sqarojnë dispozitat e ligjit dhe japin më shumë hollësi se si të zbatohen në praktikë.

Aktet nënligjore të miratuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, gjatë këtij viti, janë:

1. *Rregullën Zgjedhore Nr. 18/2016 për Emërimin, Përbërjen dhe Funksionimin e Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve;*
2. *Rregullën Nr. 19/2016 për Këshillat e Vendvotimeve;* dhe
3. *Udhëzuesin për Menaxherët dhe stafin e Qendrave të Votimit.*

# 3. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT

### 3.1. Misioni

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është institucion i përhershëm që në fushëveprimtarinë e tij e ka të përcaktuar të organizojë zgjedhje kredibile dhe me standarde të larta, duke u ofruar të gjithë qytetarëve mundësi dhe shërbime cilësore zgjedhore për ushtrimin e të drejtës së tyre për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur.

### 3.2. Vizioni

KQZ-ja angazhohet për një institucion të qëndrueshëm, të pavarur dhe inovativ, që forcon demokracinë përmes zgjedhjeve, të cilat gëzojnë besimin e qytetarëve dhe akterëve tjerë.

### 3.3. Kompetencat e KQZ-së

Kompetencat e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve janë përcaktuar në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe në Ligjin për Zgjedhjet Lokale. Kësisoj, gjatë zbatimit të mandatit të vet KQZ-ja ndërmerr veprime të shumta, si në vijim:

- *ndërmerr aktivitete për edukimin e votuesve, me qëllim të ngritjes së vetëdijësimit të votuesve dhe pjesëmarrjes së tyre në zgjedhje;*

- *ndërmerr projekte ose kërkime lidhur me sistemin zgjedhore dhe çështjet që lidhen me të;*

- *krijon procedura të përshtatshme dhe ndërmerr aktivitete për të garantuar se të gjithë personat me aftësi të kufizuara mund ta ushtrojnë të drejtën e tyre të votimit dhe të marrin pjesë tërësisht në procesin zgjedhor në Kosovë, dhe*

- *kryen çdo fuknsion tjetër ndihmës për mbajtjen e zgjedhjeve në Kosovë që i përcaktohet me Rregulloret relevante dhe instrumentet ndihmëse, përfshirë veprimet e domosdoshme për mbrojtjen e integritetit të procesit zgjedhor në rast shfaqjene të një force madhore.*

# 4. FUSHËVEPRIMI QË E MBULON INSTITUCIONI

### 4.1. Mandati i KQZ-së

KQZ-ja është organ i përhershëm, i pavarur, që përgatit, mbikëqyr, drejton dhe verifikon të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve dhe referendumeve, si dhe shpallë rezultatet e tyre.

### 4.2. Përgjegjësitë

Kushtetuta e Republikës së Kosovës përcakton në mënyrë të përgjithshme përgjegjësitë dhe funksionet e KQZ-së, ndërsa me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligjin për Zgjedhjet Lokalë në Republikën e Kosovës janë përcaktuar në mënyrë më të specifikuar këto përgjegjësi dhe funksionet e KQZ-së.

Neni 64 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme përcaktohen qartë përgjegjësitë dhe funksionet e KQZ-së, si në vijim:

- *Përgatitja dhe shpallja e rregullave, formave dhe procedurave zgjedhore që kanë të bëjnë me zbatimin e këtij ligji dhe me çdo çështje tjetër që ka të bëjë me drejtimin e zgjedhjeve në kuadër të kompetencave të veta;*

- *Publikimi i të gjitha rregullave të miratuara, rregullave, udhëzimeve dhe procedurave zgjedhore duke i bërë ato të arritshme për opinionin;*

- *Krijimi dhe mbajtja e Listës së Personave që kanë të drejtë të votojnë në zgjedhje të veçanta;*

- *Mbajtja e Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim ashtu siç është paraparë me këtë ligj;*

- *Hartimi dhe miratimi i Fletëvotimeve dhe materialeve të tjera zgjedhore;*

- *Akredimi i vëzhguesve të zgjedhjeve;*

- *Krijimi, mirëmbajtja dhe certifikimi i Listës së Votuesve lidhur me zgjedhjet;*

- *Numërimi, tabulimi dhe certifikimi i rezultateve të zgjedhjeve;*

- *Regjistrimi dhe certifikimi i subjekteve politike.*

### 4.3. Përbërja e KQZ-së

Përbërja e KQZ-së është e përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Në nenin 139, paragrafët 2, 3 dhe 4 të Kushtetutës, rregullohet saktësisht përbërja, emërimi i Kryesuesit dhe anëtarëve të KQZ-së, si në vijim:

> *"Komisioni përbëhet nga njëmbëdhjetë (11) anëtarë. Kryesuesin e emëron Presidenti i Republikës së Kosovës nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme apo të Gjykatave me juridiksion apeli. Gjashtë (6) anëtarë të tjerë, emërohen nga pjesëtarët e gjashtë grupeve më të mëdha parlamentare të përfaqësuara në Kuvend. Një (1) anëtar emërohet nga deputetët e Kuvendit të cilët mbajnë vende të rezervuara apo të garantuara për komunitetin serb të Kosovës, dhe tre (3) anëtarë nga deputetët e Kuvendit, të cilët mbajnë vende të rezervuara apo të garantuara për komunitetet e tjera që nuk janë shumicë në Kosovë.*

Valdete Daka është emëruar me datë 16 qershor 2010 anëtare dhe kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ndërsa, pas Zgjedhjeve të Parakoshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura më 8 qershor 2014, sipas propozimit të Grupeve Parlamentare të Kuvendit të Republikës së Kosovës anëtarët tjerë të KQZ-së janë:

1. Betim Gjoshi – *i nominuar nga Partia Demokratike e Kosovës;*
2. Sami Hamiti – *i nominuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës;*
3. Adnan Rrustemi – *i nominuar nga Lëvizja Vetëvendosje;*
4. Binak Vishaj – *i nominuar nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës;*
5. Eshref Vishi – *i nominuar nga Nisma për Kosovën;*
6. Ilir Gashi – *i nominuar nga Partia Demokratike e Kosovës;*
7. Nenad Rikalo – *i nominuar nga Lista Serbe;*
8. Ercan Spat – *i nominuar nga Partia Demokratike Turke e Kosovës;*
9. Bajram Ljatifi – *i nominuar nga Koalicioni VAKAT;* dhe
10. Ergit Qeli – *i nominuar nga Partia Liberale Egjiptiane.*

### 4.4. Këshillat e KQZ-së

Në bazë të Rregullores së Punës, KQZ-ja është e organizuar në pesë (5) Këshilla të Përhershëm dhe Komitetin e Auditimit. Roli i tyre është shqyrtimi i çështjeve përkatëse dhe përgatitja e rekomandimeve apo e raporteve për miratim nga KQZ-ja. Këshillat e KQZ-së janë:

1. *Këshilli për Operacione Zgjedhore;*
2. *Këshilli për Çështje Ligjore;*
3. *Këshilli për Personel;*
4. *Këshilli për Buxhet dhe Financa*
5. *Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë;* dhe
6. *Komiteti i Auditimit.*

### 4.5. Struktura dhe organizimi i Sekretariatit të KQZ-së

Sekretariati ndihmon KQZ-në në kryerjen e përgjegjësive dhe funksioneve të tij si dhe zbaton vendimet e KQZ-së. Po ashtu, Sekretariati përgatit raporte dhe rekomandime për vendimet e KQZ-së dhe siguron ndihmë tjetër të nevojshme administrative për KQZ-në.

### 4.6. Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim (ZRPPC)

Në pajtueshmëri me ligjin, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka themeluar Zyrën për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim (ZRPPC). Zyra është përgjegjëse për *mirëmbajtjen dhe azhurnimin e Regjistrit të Partive Politike*; *për certifikimin e Subjekteve Politike dhe Kandidatëve të tyre për zgjedhje*; *kufizimin e shpenzimeve të subjekteve të certifikuara politike gjatë fushatave*; si dhe *pranimin e Deklarimeve Financiare*.

### 4.7. Komisionet Komunale të Zgjedhjeve (KKZ)

Komisionet Komunale të Zgjedhjeve janë trupa të themeluara nga KQZ-ja në tridhjetëetetë (38) komuna të Republikës së Kosovës, për të ndihmuar në organizimin e zgjedhjeve. KKZ-të janë përgjegjëse për administrimin e zgjedhjeve brenda komunave, nën mbikëqyrjen dhe udhëzimet e KQZ-së nëprmjet Sekretariatit, me qëllim të garantimit të ligjshmërisë, legjitimitetit dhe efikasitetit të procesit zgjedhor.

### 4.8. Burimet njerëzore

KQZ-ja ka njëmbëdhjetë (11) anëtarë dhe shtatëdhjetëeshtatë (77) zyrtarë të Sekretariatit të KQZ-së. Nga numri i përgjithshëm i zyrtarëve të Sekretariatit tridhjetëetetë (38) prej tyre janë Zyrtarë të Lartë Komunal të Zgjedhjeve (ZLKZ), pra nga një (1) zyrtar për secilën komunë të Kosovës.

| STRUKTURA KUALIFIKUESE | | |
|---|---|---|
| **Fakultet** | **Shkollë e Lartë** | **Shkollë e Mesme** |
| **60** | **2** | **10** |

***Tabela 1:*** *Struktura kualifikuese e stafit të SKQZ-së*

| STRUKTURA ETNIKE | | |
|---|---|---|
| Shqiptarë | Serbë | Turq |
| 62 | 9 | 1 |

***Tabela 2:*** *Struktura etnike e stafit të SKQZ-së*

| STRUKTURA GJINORE | |
|---|---|
| Meshkuj | Femra |
| 51 | 21 |

***Tabela 3:*** *Struktura gjinore e stafit të SKQZ-së*

Struktura organizative e Sekretariatit është e organizuar në këtë mënyrë: *Departamenti i Operacioneve Zgjedhore, Departamenti i Administratës dhe Përkrahjes, Departamenti për Çështje Ligjore, Departamenti për Teknologji Informative, Drejtori i Auditimit, Drejtori i Prokurimit, Koordinatori i ZLKZ-ve, Koordinatori i Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve, dhe Zyrtari i Lartë Certifikues.*

Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim funksionon si pjesë e Sekretariatit të KQZ-së dhe i raporton drejtpërdrejtë KQZ-së.

### *4.8.1. Trajnimi i stafit*

| | Titulli i trajnimit | Kohëzgjatja | Muaji | Data | Pjesmarrësit |
|---|---|---|---|---|---|
| **1** | Menaxhimi vartesve | 1 x 3 dite | Shkurt 2016 | 10-12 Shkurt | Menaxheret & Koordinatoret **10** persona |
| **2** | Profesionalizmi në adminstr. zgjedhore | 1 x 2 dite | Shkurt 2016 | 25-26 Shkurt | Stafi i SKQZ-së **25** persona |
| **3** | Hartimi akteve nën ligjore | 1 x 3 dite | Mars 2016 | 09-11 Mars | Zyra Ligjore, ZRPP, Kryeshefi, KQZ **10** persona |
| **4** | Hartimi shkresave dhe raporteve | 2 x 2 dite | Mars 2016 | **Grupi 1:** 21-22 Mars **Grupi 2:** 23-24 Mars | Stafi i SKQZ-së **72** persona |
| **5** | Hulumtim, monitorim dhe vleresim | 1 x 3 dite | Prill 2016 | 4-6 Prill | Menaxheret & Koordinatoret **10** persona |
| **6** | Trajnim per trajnerë profesional | 2 x 5 dite | Prill 2016 | **Grupi 1:** 18-22 Prill **Grupi 2:** 25-29 Prill | ZLKZ dhe Kordinatoret e ZLKZ dhe Trajnimit **40** persona |
| **7** | Hartimi programeve trajnuese | 1 x 4 dite | Maj 2016 | 16-19 Maj | **20** Trajnerë Profesional "Mjeshter" (ZLKZ) |
| **8** | Planifikimi ne zgjedhje | 3 x 2 dite | Maj-Qershor 2016 | **Grupi 1:** 30-31 Maj **Grupi 2:** 02-03 Qershor **Grupi 3:** 06-07 Qershor | Stafi i SKQZ-së **72** persona |
| **9** | Menaxhimi ne zgjedhje | 1 x 2 dite | Qershor 2016 | 13 -14 Qershor | Ekipi Menaxhues dhe ZLKZ të rinj **25** persona |
| **10** | Sesion plotesues "Menaxhimi i Vartesve" | 1 x 1/2 dite | Qershor 2016 | 9 Qershor | Menaxhmenti SKQZ |
| **11** | Menagjimi i ciklit të projektit | 1 x 2 dite | Maj 2016 | 30-31 Maj | Menaxheret , Koordinatorët, staf, ZLKZ të SKQZ-së. |

***Tabela 4**: Lista e trajnimeve për vitin 2016*

Gjatë vitit 2016 janë organizuar trajnime sipas Planit të Trajnimit të miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ku zyrtarët e Sekretariatit kanë marrë pjesë edhe në trajnimet e organizuara nga IKAP-i. Këto trajnime do t'i shërbejnë forcimit të kapaciteteve tona të brendshme në përmbushje të fushëveprimit të institucionit.

Gjitashtu stafi i SKQZ-ë ka ndjekur pesë (5) trajnime në Institutin e Kosovës për Administratë Publike, si dhe një (1) trajnim përmes Arkivit të Kosovës.

Gjatë vitit 2016, me ftesë të Asociacionit të Trupave Zgjedhore Botërore (A-ËEB) dy përfaqësues nga KQZ morën pjesë në programin e trajnimit për e ekspertët e zgjedhjeve nga vendet anëtare të A-ËEB, mbajtur nga data 11 deri më 17 dhjetor 2016 në Incheon të Koresë së Jugut. Qëllimi i programit ishte të rrisë ekspertizën teorike dhe praktike në menaxhimin e zgjedhjeve.

## 4.9. Asetet e Institucionit

| | 2016 | 2015 | 2014 |
|---|---|---|---|
| **Klasifikimi i pasurive** | € '000 | € '000 | € '000 |
| | | | |
| **Ndërtesat** | | | |
| **Toka** | | | |
| **Pajisjet** | | | |
| **Infrastruktura** | | | |
| **Makineria** | | | |
| **Automjetet** | 14 | 28 | 42 |
| **Tjera** | 88 | 101 | 83 |
| **GJITHSEJ** | 102 | 129 | 125 |

***Tabela 5:*** *Përmbledhja e pasurive jo-financiare kapitale (me vlerë mbi 1000 Euro) në posedim të KQZ-së*

# 5. AKTIVITETET PËR PERIUDHËN RAPORTUESE

Në vazhdim janë pasqyruar aktivitetet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për periudhën raportuese. Në pjesën e parë paraqiten aktivitetet e KQZ-së jashtë procesit zgjedhor dhe që ndërlidhen me Planin e Punës për vitin 2016 dhe aktivitetet tjera zhvillimore.

Në përfundim të këtij kapitulli, hapësirë të veçantë i është kushtuar bashkëpunimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve brenda dhe jashtë vendit.

## 5.1. Aktivitetet sipas Planit të Punës

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka zhvilluar aktivitete të ndryshme të parashikuara në Planin e Punës për vitin 2016. Shumë nga këto aktivitete i shërbejnë fuqizimit të KQZ-së.

### *5.1.1. Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim (ZRPPC)*

Gjatë këtij viti, duke u mbështetur në Rekomandimet e Zyrës për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim, Komisioni Qendror i zgjedhjeve ka marrë 94 vendime.

#### *5.1.1.1. Azhurnimi vjetor i të dhënave të partive politike*

Nga pesëdhjetë e nëntë (59) parti politike të regjistruara dyzetë e një (41) prej tyre i kanë dorëzuar azhurnimet vjetore në afatin e paraparë ligjor, ndërsa në pajtim me Nenin 6 të Rregullës 01/2013 për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, për shkak të mosrespektimit të afatit, KQZ-ja ka *pezulluar* katërmbëdhjetë (14) parti politike.

Kurse, me datë 24 shkurt 2016 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mori vendim për *shfuqizimin e masës së pezullimit* për dhjetë (10) parti politike, pasi në afatin shtesë përmbushën obligimet që dalin nga Neni 6.5 i Rregullës 01/2013 për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike.

| LISTA E PARTIVE POLITIKE TË PEZULLUARA | | LISTA E PARTIVE POLITIKE PAS LARGIMIT TË MASËS SË PEZULLIMIT |
|---|---|---|
| **AKRONIMI** | **EMRI I PARTISË POLITIKE** | **EMRI I PARTISË POLITIKE** |
| **NCPK** | NARODNA CRNOGORSKA PARTIJA KOSOVA | |
| **PGJK** | PARTIA E TË GJELBËRVE TË KOSOVËS | PARTIA E TË GJELBËRVE TË KOSOVËS |
| **PLK** | PARTIA LIBERALE E KOSOVËS | PARTIA LIBERALE E KOSOVËS |
| **PSHDK** | PARTIA SHQIPTARE DEMOKRISTIANE E KOSOVËS | PARTIA SHQIPTARE DEMOKRISTIANE E KOSOVËS |
| **SD** | SOCIJALDEMOKRATIJA | |
| **NPK** | NOVA PARTIJA KOSOVA | NOVA PARTIJA KOSOVA |
| **DSK** | DEMOKRACIA SOCIALE E KOSOVËS | |
| **LRD** | LËVIZJA E RE DEMOKRISTIANE | LËVIZJA E RE DEMOKRISTIANE |
| **FDBK** | FRONTI DEMOKRATIK PËR BASHKIM KOMBËTAR | FRONTI DEMOKRATIK PËR BASHKIM KOMBËTAR |
| **LISBA** | LËVIZJA ISLAME BASHKOHU | LËVIZJA ISLAME BASHKOHU |
| **SNPK** | SRPSKA NARODNA PARTIJA KOSOVA | |
| **REK** | REPUBLIKANËT E KOSOVËS | REPUBLIKANËT E KOSOVËS |
| **JGP** | JEDINSTVENA GORANSKA PARTIJA | JEDINSTVENA GORANSKA PARTIJA |
| **PB** | PARTIA E BALLIT | PARTIA E BALLIT |

***Tabela 6:*** *Lista e partive politike të Pezulluara dhe lista e partive politike pas largimit të masës së pezullimit*

Gjatë vitit 2016, sipas Rekomandimeve të ZRPPC, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duke u bazuar në Nenin 8 pika 8.1 e) e Rregullës 01/2013 për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike ka çregjistruar nga Regjistri i Partive Politike pese (5) parti politike.

| LISTA E PARTIVE POLITIKE TË ÇREGJISTRUARA | | | |
|---|---|---|---|
| **NR.** | **AKRONIMI** | **EMRI I PARTISË** | **DATA E ÇREGJISTRIMIT** |
| **1** | SD | SOCIJALDEMOKRATIJA | 16.03.2016 |
| **2** | NCPK | NARODNA CRNOGORSKA PARTIJA KOSOVA | 16.03.2016 |
| **3** | DSK | DEMOKRACIA SOCIALE E KOSOVËS | 16.03.2016 |
| **4** | PDKI | PARTIA DEMOKRISTIANE PËR INTEGRIM | 26.04.2016 |
| **5** | BD | BASHKIMI DEMORATIK | 13.10.2016 |

***Tabela 7**: Lista e partive politike të çregjistruara (2016)*

Partitë Politike të cilat kanë dorëzuar me vonesë Azhurnimet Vjetore për vitin 2015 janë gjobitur sipas rregullativës në fuqi.

| GJOBAT NDËSHKUESE PËR VONESË NË DORËZIMIN E AZHURNIMEVE VJETORE PËR VITIN 2015 | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **NR.** | **EMRI I SUBJEKTIT POLITIK** | | **PËRFAQËSUAR NË KUVEND** | **VONESA NË DITË** | **TOTALI GJOBËS** |
| **1** | **PAI** – PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM | Parti politike | PO | 3 ditë | 500 € |
| **2** | **PD** – PARTIA E DREJTËSISË | Parti politike | PO | 3 ditë | 500 € |
| **3** | **KTAP** – KOSOVA TURK ADALET PARTISI | Parti politike | JO | 3 ditë | 300 € |
| **4** | **PGJK** – PARTIA E TË GJELBËRVE TË KOSOVËS | Parti politike | JO | 8 ditë | 320 € |
| **5** | **PSHDK** – PARTIA SHQIPTARE DEMOKRISTIANE E KOSOVËS | Parti politike | JO | 8 ditë | 320 € |
| **6** | **LRD** – LËVIZJA E RE DEMOKRISTIANE | Parti politike | JO | 8 ditë | 320 € |
| **7** | **JGP** – JEDINSTVENA GORANSKA PARTIJA | Parti politike | JO | 8 ditë | 320 € |
| **8** | **NPK** – NOVA PARTIJA KOSOVA | Parti politike | JO | 10 ditë | 320 € |
| **9** | **FDBK** – FRONTI DEMOKRATIK PËR BASHKIM KOMBËTAR | Parti politike | JO | 10 ditë | 320 € |
| **10** | **LISBA** – LËVIZJA ISLAME BASHKOHU | Parti politike | JO | 10 ditë | 320 € |
| **11** | **REK** – REPUBLIKANËT E KOSOVËS | Parti politike | JO | 10 ditë | 320 € |
| **12** | **PB** – PARTIA E BALLIT | Parti politike | JO | 10 ditë | 320 € |
| **13** | **PLK** – PARTIA LIBERALE E KOSOVËS | Parti politike | JO | 14 ditë | 350 € |
| **14** | **SNPK** – SRPSKA NARODNA PARTIJA KOSOVA | Parti politike | JO | 20 ditë | 350 € |

***Tabela 8:** Lista e partive politike të gjobitura për vonesë në dorëzimin e Azhurnimeve 2015*

#### *5.1.1.2. Regjistrimi i Partive Politike*

Në pajtim me Nenin 12 të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe me Rregullën 01/2013 për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, gjatë vitit 2016 janë regjistruar tri (3) parti politike.

| NR. | AKRONIMI | EMRI I PARTISË | DATA E REGJISTRIMIT |
|---|---|---|---|
| **1** | NISMA | NISMA PËR KOSOVËN | 25.05.2016 |
| **2** | AGI | AKTIVNA GRADANSKA INICIJATIVA | 25.05.2016 |
| **3** | NSK | NAPREDNA SNAGA KOSOVA | 10.11.2016 |

***Tabela 9**: Lista e partive politike të regjistruara më 2016*

#### *5.1.1.3. Pranimi i Raporteve Vjetore Financiare*

Në pajtim me obligimet që dalin nga Neni 15 i Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike dhe Nenit 7 të Rregullës Nr. 14/2015 mbi Financimin e Subjekteve Politike dhe Sanksionet, ZRPPC ka pranuar 58 raporte vjetore financiare të subjekteve politike, 55 raporte të partive politike dhe 3 raporte të nismave qytetare.

#### *5.1.1.4. Monitorimi i Kuvendeve të Partive Politike*

Gjatë vitit 2016, në periudhën janar – dhjetor, janë monitoruar dymbëdhjetë (12) Kuvende Zgjedhore të Partive Politike, të paraqitura si në vijim:

| AKRONIMI | EMRI I PARTISË | DATA |
|---|---|---|
| **PSHDK** | PARTIA SHQIPTARE DEMOKRISTIANE E KOSOVËS | 26.03.2016 |
| **IRDK** | INICIATIVA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVËS | 24.04.2016 |
| **PDK** | PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS | 07.05.2016 |
| **NBS** | NOVA BOŠNJAČKA STRANKA | 15.05.2016 |
| **OBKD** | ORGANIZATA BALLI KOMBËTAR DEMOKRAT | 10.06.2016 |
| **BKK** | BALLI KOMBËTAR I KOSOVËS | 22.06.2016 |
| **GIG** | GRAĐANSKA INICIJATIVA GORE | 25.06.2016 |
| **NISMA** | NISMA PËR KOSOVËN | 25.06.2016 |
| **AGI** | AKTIVNA GRAĐANSKA INICIJATIVA | 10.09.2016 |
| **LQV** | LËVIZJA QYTETARE VATRA | 27.11.2016 |
| **PSD** | PARTIA SOCIALDEMOKRATE | 17.12.2016 |
| **PLK** | PARTIA LIBERALE E KOSOVËS | 17.12.2016 |

***Tabela 10:*** *Lista e Kuvendeve të partive politike të monitoruara gjatë vitit 2016*

#### *5.1.1.5. Takimet me përfaqësues të Subjekteve Politike dhe trajnimet e përfaqësuesve financiar të tyre*

Duke u bazuar në nenin 40.7 të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ZRPPC ka mbajtur 5 trajnime dhe takime me përfaqësuesit financiar dhe përfaqësuesit e autorizuar kontaktues të Subjekteve Politike.

| Trajnimet-Takimet e mbajtura nga Zyra për Regjistrim të Partive Politike – ZRPPC | Tema | Data e mbajtjes së trajnimeve-takimeve | Mbështetur nga: |
|---|---|---|---|
| Trajnime për Përfaqësuesit Financiar të Subjekteve Politike | Plotësimin e Raporteve financiare, pasqyrave financiare, pasqyrave të hyrave dhe shpenzimeve, donacioneve dhe kontributeve në të holla dhe pagesat tjera. | 09.02.2016 | IFES |
| Takim me Përfaqësuesit e kontaktues të Subjekteve Politike | Procedurat e shkrirjes dhe bashkimit të partive politike | 26.04.2016 | KQZ |
| Takim me Përfaqësuesit e Subjekteve Politike/Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Gllogoc | Informimi i Subjekteve Politike lidhur me afatet e aktiviteteve zgjedhore si dhe informimin për hapjen e katër (4) Qendrave të Votimit në Komunën e Gllogocit | 10.11.2016 | KQZ |
| Takim i përbashkët i ZRPPC dhe DOZ-it, me | Certifikimi i Anëtarëve të | 15.11.2016 | KQZ |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Përfaqësuesit e Subjekteve Politike/Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Gllogoc | Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve | | |
| Afatet ligjore dhe sanksionet | Obligimet e Subjekteve Politike në raport me KQZ-në | 22.12.2016 | KQZ |

***Tabela 11:*** *Trajnimet dhe takimet e mbajtura nga ZRPPC*

### *5.1.2. Shërbimi i votuesve*

Komisioni Qendror i Zgjedhje ka vazhduar me angazhimet e tij në drejtim të përmbushjes së kërkesave dhe krijimit të kushteve për votuesit në Republikën e Kosovës. Në këtë drejtim, janë themeluar qendra të reja votimi, si një rrethanë lehtësuese që votuesit të mund të votojnë sa më afër vendbanimit të tyre.

Gjithashtu, KQZ-ja ka vazhduar me angazhimet me qëllim të përmirësimit të Listës së Votuesve, duke bashkëpunuar edhe me institucione tjera.

#### *5.1.2.1. Analizë e krijimit të Listës së Votuesve dhe Votave me Kusht për Zgjedhjet 2014*

Gjatë vitit 2016 është hartuar një raport me qëllim të publikimit të një analize të krijimit të Listës së Votuesve. Analiza përfshin të dhënat për votuesit në dy aspekte:

- *Votuesit që kanë votuar në Vendvotimet e rregulla në Ditën e Zgjedhjeve, dhe*
- *Analizë e Votave me Kusht – votuesit që kanë votuar me kusht nga një komunë në komunën tjetër dhe arsyet e votimit me kusht brenda komunës.*

Lidhur me këtë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka hartuar një raport me qëllim të nxjerrjes së të dhënave të përgjithshme të votave me kusht, që janë hedhur në vendvotimet e dyfishta në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të vitit 2014, duke i nxjerrë numrin total të votave me kusht për:

- ✓ *Çdo komunë,*
- ✓ *Numrin total të votave me kusht që janë hedhur nga votuesit në komuna të ndryshme, nga komunat ku janë caktuar të votojnë në ditën e zgjedhjeve në LPV përkatëse,*
- ✓ *Numrin e votave me kusht brenda komunave.*

| KODI KOMUNAL | KOMUNAT | NUMRI TOTAL I VOTUESVE NË LPV | NUMRI TOTAL I VOTUESVE QË KANË VOTUAR | VOTAT ME KUSHT | PËRQINDJA |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | DEÇAN | 40212 | 14796 | 187 | 1.26% |
| 2 | GJAKOVË | 107844 | 37241 | 974 | 2.62% |
| 3 | GLLOGOC | 50231 | 24976 | 887 | 3.55% |
| 4 | GJILAN | 94425 | 41548 | 492 | 1.18% |
| 5 | DRAGASH | 39172 | 13039 | 271 | 2.08% |
| 6 | ISTOG | 45905 | 16808 | 343 | 2.04% |
| 7 | KAÇANIK | 32373 | 12714 | 270 | 2.12% |
| 8 | KLINË | 44270 | 16513 | 227 | 1.37% |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 9 | FUSHË KOSOVË | 32085 | 13114 | 588 | 4.48% |
| 10 | KAMENICË | 37428 | 15728 | 262 | 1.67% |
| 11 | MITROVICË | 72764 | 28595 | 1147 | 4.01% |
| 12 | LEPOSAVIÇ | 18268 | 4681 | 242 | 5.17% |
| 13 | LIPJAN | 55555 | 26749 | 417 | 1.56% |
| 14 | NOVOBËRDË | 9243 | 4178 | 115 | 2.75% |
| 15 | OBILIQ | 23224 | 10080 | 311 | 3.09% |
| 16 | RAHOVEC | 53936 | 21180 | 527 | 2.49% |
| 17 | PEJË | 103490 | 39915 | 818 | 2.05% |
| 18 | PODUJEVË | 80526 | 35647 | 815 | 2.29% |
| 19 | PRISHTINË | 172289 | 84314 | 4065 | 4.82% |
| 20 | PRIZREN | 156970 | 60028 | 2677 | 4.46% |
| 21 | SKËNDERAJ | 52641 | 25788 | 940 | 3.65% |
| 22 | SHTIME | 24511 | 11021 | 172 | 1.56% |
| 23 | SHTËRPCË | 13834 | 6676 | 45 | 0.67% |
| 24 | SUHAREKË | 62230 | 26735 | 382 | 1.43% |
| 25 | FERIZAJ | 100675 | 43707 | 705 | 1.61% |
| 26 | VITI | 46348 | 18061 | 240 | 1.33% |
| 27 | VUSHTRRI | 68210 | 27681 | 710 | 2.56% |
| 28 | ZUBIN POTOK | 8021 | 2858 | 18 | 0.63% |
| 29 | ZVEÇAN | 9676 | 2146 | 70 | 3.26% |
| 30 | MALISHEVË | 48430 | 21893 | 334 | 1.53% |
| 31 | JUNIK | 5546 | 2087 | 34 | 1.63% |
| 32 | MAMUSHË | 3642 | 1756 | 20 | 1.14% |
| 33 | HANI I ELEZIT | 8554 | 3675 | 28 | 0.76% |
| 34 | GRAÇANICË | 19623 | 7727 | 522 | 6.76% |
| 35 | RANILLUG | 5649 | 2473 | 104 | 4.21% |
| 36 | PARTESH | 4426 | 2158 | 16 | 0.74% |
| 37 | KLLOKOT | 3396 | 1668 | 83 | 4.98% |
| 38 | MITROVICË E VERIUT | 26832 | 4562 | 332 | 7.28% |
| | **TOTALI** | **1782454** | **734516** | **20390** | **2.78%** |

***Tabela 12:*** *Paraqitja e numrit të përgjithshëm të votuesve për zgjedhjet 2014 e paraqitur për çdo komunë, numri i votuesve që kanë votuar në vendvotime, numrit të votuesve që kanë votuar me kusht dhe përqindja e votuesve që kanë votuar me kusht në raport me daljen në votime*

#### *5.1.2.2. Themelimi i Qendrave të Reja të Votimit*

Në përputhje me kërkesat dhe rrethanat në terren, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mund të themelojë qendra të reja votimi.

Gjatë vitit 2016, si rezultat i vlerësimit të nevojave për themelimin e qendrave të reja të votimit, e që janë propozuar përmes kërkesave të palëve tjera (subjektet politike dhe vlerësimet e bëra nga vetë KQZ-ja), në këtë vit ka themeluar 91 Qendra të Votimit.

Gjithashtu, në themelimin e qendrave të reja të votimit janë përfshirë edhe të dhënat që janë analizuar për vendbanimet me numër të caktuar të votuesve dhe që në ditën e zgjedhjeve mund të votojnë eventualisht larg vendbanimit të tyre, megjithëse në vendbanimet e tyre është vërtetuar se kanë objekte shkollore që mund të përdoren si qendra të votimit. Kjo analizë, është bërë duke e vlerësuar mekanizmin e caktimit të votuesve nëpër qendra të votimit (master listën) e vendbanimeve me numrin e votuesve.

Pas këtyre vlerësimeve që janë bërë, është arritur që të krijohen qendra të reja të votimit në njëzet e katër (24) komuna të Republikës së Kosovës, si në vijim:

| KOMUNA | NUMRI I QV-VE TË REJA | KOMUNA | NUMRI I QV-VE TË REJA |
|---|---|---|---|
| **Deçan** | 6 | **Pejë** | 1 |
| **Gjakovë** | 6 | **Podujevë** | 2 |
| **Gllogoc** | 4 | **Prishtinë** | 1 |
| **Gjilan** | 1 | **Prizren** | 6 |
| **Dragash** | 3 | **Skënderaj** | 3 |
| **Istog** | 8 | **Shtime** | 6 |
| **Kaçanik** | 2 | **Suharekë** | 1 |
| **Klinë** | 3 | **Ferizaj** | 7 |
| **Fushë Kosovë** | 3 | **Viti** | 4 |
| **Kamenicë** | 2 | **Vushtrri** | 6 |
| **Lipjan** | 5 | **Garaçanicë** | 5 |
| **Obiliq** | 3 | **Ranillugë** | 3 |

***Tabela 13:*** *Paraqitja tabelare e qendrave të reja të votimit për secilën komunë.*

#### *5.1.2.3. Analizë lidhur me zbatimin e projektit për votuesit e verbër dhe me të pamur të dobësuar*

Në kuadër të Planit të Punës së KQZ-së për vitin 2016 dhe në bazë të detyrimeve për implementimin e aktiviteteve të parapara me këtë plan, KQZ-ja ka bërë një analizë të zbatimit të projektit për votuesit e verbër nga zgjedhjet e kaluara, duke identifikuar pengesat me të cilën është ballafaquar implementimi i projektit në tërësi dhe duke identifikuar çështjet që duhet të merren për bazë për përmirësim në zgjedhjet e ardhshme.

Në kuadër të këtij aktiviteti, janë realizuar takime me zurtarët e Shoqatës së të Verbërve dhe me të pamë të dobësuar të Republikës së Kosovës, ku janë diskutuar aspektet që kanë të bëjnë me implementimin e projektit të përbashkët që votuesit e verbër dhe me të pamë të dbësuar të votojnë personalisht dhe pa asistencë, sic janë:

- *Materialet e shtypura (shabllonet dhe informatorët në BRAIL),*
- *Zhvillimin e një moduli të veçantë për trajnimin e votuesve të verbër,*
- *Për prezencën e votuesve të verbër në tavolinat ndihmëse,*
- *Hapësirën mediatike, dhe*
- *Edukimi i votuesve përmes punëtorive, të organizuara dhe mbikëqyrur në bashkëpunim me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.*

#### *5.1.2.4. Përmirësimi dhe Qëndrueshmëria e Listës së Votuesve: Vendbanimi im, vendvotimi im*

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me mbështetje të USAID/IFES në Kosovë, ka filluar ta zbatojë projektin për përmirësimin e Listës së Votuesve "Vendbanimi im, vendvotimi im".

Përmes këtij projekti, KQZ-ja ka përcaktuar metodën e krijimit të listës së votuesve për të ardhmen, duke përdorur Sistemi GIS, i cili do të shfrytëzohet për të krijuar harta digjitale që do t'i përfshijnë fshatrat, rrugët, segmentet e rrugëve si dhe adresat e objekteve që janë identifikuar nga sistemi ARIS i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, të cilat janë të ngarkuara në gjeoportalin shtetërorë të Republikës së Kosovës.

Duke përdorur sistemin GIS, do të mundësohet që në mënyrë automatike të selektohen të gjitha fshatrat, rrugët dhe segmentet e rrugëve si dhe adresat e objekteve, të cilat përfshihen në kuadër të poligoneve dhe t'i ngarkojë këto njësi të adresave në listat e votuesve që do të krijohen për çdo qendër të votimit.

Për nevoja të ecurisë dhe imeplemtnitimit të projektit, KQZ-ja së bashkë me Agjencinë Kadastrale të Kosovës ka nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit që ka për qëllim shkëmbimin e të dhënave dhe produkteve, pa kosto financiare, siç janë: kufijtë komunal, emërtimet e vendbanimeve, rrugët, kodet e rrugëve, segmenti i rrugës dhe numrat e ndërtesave dhe hyrjeve. Gjithashtu, përmes kësaj marrëveshje janë përcaktuar kushtet e shkëmbimit për të dhënat në mes të dy institucioneve, siç janë kufijtë e qendrave të votimit, të cilat do të përcaktohen përmes elementit të poligoneve.

#### *5.1.2.5. Aktivitetet e grupit punues KQZ – MPB për përmirësimin e Listës së Votuesve*

Gjatë periudhës 4 prill 2016 deri më 21 dhjetor 2016, Grupi Punues për përmirësimin e listës së votuesve ka mbajtur tri (3) takime (në datat: 01.02.2016, 18.02.2016 dhe 01.04.2016).
Në këto takime janë prezantuar raportet:

a) *Raportit për përmirësimin e Listës së Votuesve për të gjeturat lidhur me adresat, emrat e qytetarëve 100 vjeç e mbi dhe emrat e personave të vdekur që nuk janë lajmëruar në zyrat e gjendjes civile,*
b) *Plani i veprimit për Zyrtarët e Lartë Komunal të Zgjedhjeve, që përmbajnë:*

- *Identifikimi në terren i qytetarëve që kanë mbushur moshën 100 vjeç dhe mbi 100 vjeç,*
- *Kërkesë Drejtorive arsimit nëpër komuna për informatat që kanë të bëjnë me të dhënat e të gjitha objekteve shkollore,*
- *Sigurimin e emrave të rrugëve zyrtare (sipas sistemit unik të adresave) nga Drejtoritë për Urbanizëm në komunat e juaja në formatin Excel,*
- *Sigurimi i hartave për komunat, që përmbajnë emrat e rrugëve, zonat kadastrale dhe kufijtë,*

- *Mbikëqyrja e procesit në zyrat, bashkësitë lokale apo në lokacionet ku aplikohet për letërnjoftim. Kjo ka të bëjë me mbikëqyrjen dhe metodën e caktimit të adresave me rastin e aplikimit për dokumentet e identifikimit,*

c) *Raport nga Plani i Veprimit për Zyrtarët e Lartë Komunal të Zgjedhjeve në funksion të përmbushjes së aktiviteteve dhe detyrave që kanë të bëjnë me:*

- *Identifikimi në terren i qytetarëve që kanë mbushur moshën 100 vjeç dhe mbi 100 vjeç,*
    - *Sigurimi i të dhënave për: Emrin e shkollës, Lokacionin (adresa e shkollës), Kapaciteti (numrin e klasave dhe sallave brenda shkollës) dhe Sipërfaqja e shkollës në m2.*
- *Sigurimi i emrave të rrugëve nga Drejtoritë e Urbanizmit në 25 komuna.*

d) *Sigurimi i hartave elektronike për 10 komuna,*

e) *Mbikëqyrja e procesit të vendosjes së adresave nga zyrtarët përgjegjës gjatë pajisjes me dokumente për tridhjetë e dy komuna (32) komuna.*

#### *5.1.2.6. Krijimi për nevoja të brendshme i një harte/pasqyre gjeografike për ecurinë e zgjedhjeve*

Ky aktivitet, që është ndërrmarë nga KQZ-ja në vitin 2016, paraqet dokumentin ku përfshihen të dhënat gjeografike për ecurinë e zgjedhjeve, sic janë:

- *Kutitë e rinumëruara,*
- *Votat e dyfishta, dhe*
- *Ankesat që janë paraqitur në dhomën operative në ditën e zgjedhjeve.*

Këto kategori të lartpërmendura janë paraqitur për Zgjedhjet Lokale 2009, Zgjedhjet Parlamentare 2010, Zgjedhjet Lokale 2013 dhe Zgjedhjet Parlamentare 2014.

### *5.1.3. Programi i trajnimit*

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për herë të parë, ka arritur të certifikoi rreth 600 persona, anëtarë të Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve. Qëllimi i këtij programi është që të krijohet një mekanizëm i avancuar profesional ndërmjet KQZ-së dhe Subjekteve Politike gjatë ushtrimit të mandatit të anëtarëve të KKZ-ve. Personat e pajisur me certifikata mund të konsiderohen si kandidat potencial për të qenë anëtarë të Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve gjatë proceseve zgjedhore.

#### *5.1.3.1. Certifikimi i anëtarëve të Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve*

Bazuar në Strategjinë e KQZ-së për periudhën 2015 – 2018, në kuadër të bashkëpunimit me akterë të jashtëm (Shtylla VII) dhe Planin e Punës për vitin 2016, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve zbatojë programin për certifikimin e anëtarëve të Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve.

Programi u shtjellua në 4 module, të cilin e vijuan nga 3 përfaqësues të Degëve të Subjekteve Politike të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Zhvillimi i këtj programi mund të krijojë prioritete për nominime dhe emërime të anëtarëve të KKZ-ve, që në bazë të kualifikimit dhe certifikimit, këta persona, mund të konsiderohen si kandidat potencial për të qenë anëtarë të KKZ-ve gjatë proceseve zgjedhore. Gjatë zbatimit të këtij programi është respektuar edhe kuota gjinore.

Ky program do të bëhet i përhershëm gjatë viteve jo-zgjedhore.

#### *5.1.3.2. Atributet dhe aktivitetet për zbatimin e programit*

Programi i zbatuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka disa atribute, të cilat janë të përmbledhura në grafikën e mëposhtme.




Për realizimin e këtij programi janë zhvilluar disa aktivitete:

- *Takim informues me Subjekte Politike,*

- *Trajnimi i 38 Zyrtarëve të Lartë Komunal të Zgjedhjeve,*

- *Trajnimi i 584 personave të Subjekteve Politike,*

- *Certifikimi i 584 personave.*

### *5.1.4. Teknologjia Informative në zgjedhje*

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është duke u munduar që të lëvizë drejt përshtatjes së rrethanave, kërkesave dhe mundësive që ofron teknologjia e kësaj kohe. Prandaj, gjatë vitit 2016 janë realizuar projekte dhe detyra sipas planit dhe përgjegjësive, duke krijuar një sistem të qëndrueshëm dhe profesional me pajisje të avancuara teknologjike.

#### *5.1.4.1. Inovacioni dhe teknologjia*

Në vitin 2016 janë realizuar disa projekte innovative, duke krijuar një sistem të qëndrueshëm dhe profesional me pajisje me pajisje të avancuara teknologjike. Bazuar në Planin Strategjik të KQZ-së 2015-2018 dhe Memorandumin e Mirëkuptimit KQZ - USAID, Sekretariati ka ndërmarrë veprimet e nevojshme në bashkëpunim me IFES-in me qëllim të zbatimit të projekteve për modernizimin e operacioneve dhe aktivitetet zgjedhore dhe administrative.

Sistemet e zhvilluara tregojnë përkushtimin dhe punën e KQZ-së drejt vizionit për një trupe menaxhuese zgjedhore transparente dhe inovative. Kërkesat funksionale dhe teknike për këto sisteme janë zhvilluar sipas kërkesave të departamenteve specifike të Sekretariatit dhe ZRPP-së për të adresuar nevojat e KQZ-së.

Këto dy sisteme si dhe Sistemi i informatave të stafit zgjedhor i zhvilluar ne vitin 2015, por dhe projekti K-vote i implementuar ne zgjedhjet e kaluara, e vendosin KQZ-në disa hapa para në raport me TMZ-të e rajonit për sa i përket përdorimit të teknologjisë dhe inovacionit.

#### *5.1.4.2. Platforma hartografike digjitale*

Në vitin 2016 ka përfunduar zhvillimi i Platformës hartografike digjitale. Përmes kësaj Platforme, KQZ bën paraqitjen e informatave zgjedhore me theks të veçantë për çështjet e qasjes së personave me aftësi të kufizuara në procesin zgjedhor në Kosovë. DMP prezanton informatat e përgjithshme zgjedhore në nivel qendror, zyrë të KKZ-ve, dhe Qendrave të Votimit. Informatat do të përmbajnë numrin e Qendrave të Votimit dhe lokacionin, numrin e Vendvotimeve, numrin e votuesve, lokacionet (fshatrat) që votojnë në atë qendër, kontaktet/adresat e KKZ-ve. Seksion i dytë do tu mundësojë qytetarëve, OJQ-ve, subjekteve politike të jenë të informuar për shërbimet zgjedhore në nivel komunal dhe qendror.
Ky seksion prezanton vizuelisht nivelin e qasjes për personat me aftësi të kufizuara në Qendrat e Votimit, KKZ, zyrat e partive politike dhe hapësirave të shfrytëzuara për fushata zgjedhore në të gjithë Kosovën. Kjo mundet të përdoret edhe për avokim për të siguruar që këto lokacione do të bëhen të qasshme për personat me aftësi të kufizuara.
Gjithashtu DMP prezanton rezultatet e zgjedhjeve në Kosovë nga viti 2009 deri më tani. Rezultatet paraqiten në nivel qendror për të gjithë Kosovën, për komunë të caktuar dhe për qendër të caktuar të votimit (si dhe për vendovotim). Qëllimi i seksionit të tretë është të ofrojë të dhënat për rezultatet e zgjedhjeve për të gjitha palët e interesuara për tu mundësuar informim dhe kryerje të analizave të ndryshme.

#### *5.1.4.3. Platforma për modernizimin e operacioneve zgjedhore*

Bazuar në Planin e Punës, me mbështetjen e USAID përmes IFES, KQZ ka zhvilluar platformën për modernizimin e operacioneve zgjedhore. Përmes kësaj Platforme, KQZ bën me të lehtë qasjen në shërbime për votuesit, subjektet politike, OJQ-të, dhe gjithashtu bën automatizimin e veprimeve të brendshme me qellim të ngritjes se nivelit të administrimit zgjedhor.



Sistemi ka dy dimensione të funksionimit:

Atë të ofrimit te shërbimeve online i cili lehtëson qasjen në shërbime zgjedhore, dhe

- *Atë të administrimit të informatave të pranuara, jo vetëm përmes këtij procesi, por edhe ne format tjera, që e mundëson administrimin e integruar të informatave.*

Përmes ketij sistemi KQZ mundëson:

- *Digjitalizimin e procedurave për certifikimin e subjekteve politike dhe kandidatëve duke u mundësuar subjekteve politike të bëjnë aplikimin online për certifikim, duke bërë futjen e të dhënave të kandidatëve që garojnë në zgjedhje si dhe administrimin e aplikimeve (të pranuara online dhe fizikisht në letër);*
- *Digjitalizimin e procesit të ndërrimit të qendrës se votimit në mënyrë që votuesit të votojnë më afër vendbanimit të tyre si dhe mundësinë për futjen në zyrat e KKZ-ve të aplikacioneve fizike të pranuara.*
- *Për të bërë më të lehtë qasjen në materiale të trajnimit në format interaktiv për kategori të caktuara nga KQZ-ja për t'u trajnuar dhe certifikuar në kurse të ndryshme për proceset zgjedhor; dhe*
- *Digjitalizimin e procedurave për akreditimin e vëzhguesve të zgjedhjeve duke ju mundësuar SP-ve dhe OJQ të ndryshme aplikimin online për akreditim për vëzhgimin e zgjedhjeve.*



#### *5.1.4.4. Zhvillimi i Platformës për Monitorim të Shkeljeve në Zgjedhje*

KQZ në vitin 2016 ka vazhduar me zhvillimin dhe aktivitetet përgatitore për zbatimin e Projektit- Platforma për Monitorimin e Shkeljeve në Zgjedhje, e bazuar në sistemin Ushahidi, e cila ka për qëllimin grumbullimin e të dhënave për shkelje të proceseve zgjedhore gjatë gjithë ciklit të zgjedhjeve.

Kjo platformë do të mundësojë raportimet nga tereni për shkelje dhe incidente të ndryshme, përmes raportimit në uebfaqe, email, apo edhe sms. Të dhënat grumbullohen në një sistem hartografik, i cili do t'i mundësojë KQZ-së të intervenojë në situata të ndryshme, si dhe të analizojë të dhënat për të parë trendet e shkeljeve në zgjedhje. Këto analiza do ta fuqizojnë KQZ-në për të ndërmarrë masa parandaluese (duke u bazuar në ankesat e mëparshme) dhe duke reaguar më shpejtë në zgjidhjen e situatave (duke u bazuar në informatat aktuale nga vëzhguesit, dhe nga burimet e tjera të zgjedhura gjatë një periudhe zgjedhore).

Lidhur me administrimin e Platformës janë mbajtur trajnimet e stafit të Sekretariatit.
Në bashkëpunim me zyrtarët nga IFES, është hartuar Procedura e Platformës për Shkeljet Zgjedhore në Kosovë. Ky dokument është hartuar si nevojë për të ndarë përgjegjësitë dhe udhëzuar secilin se si duhet të veprojë gjatë raportimit, analizimit dhe reagimit në rast të raportimeve të shkeljeve në zgjedhje.

### *5.1.5. Informimi publik*

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ndonëse në një vit jo-zgjedhor, ka realizuar kontakte të drejtpërdrejta me të rinjtë lidhur me të drejtën e votës dhe rëndësinë e saj. Në funksion të kësaj, është miratuar projekti "Informimi dhe Edukimi i Votuesve të Rinj për Zgjedhje". Gjithashtu, për Ditën Globale të Zgjedhjeve janë mbajtur ligjerata nëpër të gjitha komunat e Kosovës me temën: "Rëndësia e pjesëmarrjes së të rinjëve në zgjedhje".

#### *5.1.5.1. Informimi dhe Edukimi i Votuesve të Rinj për Zgjedhje*

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka miratuar projektin "Informimi dhe Edukimi i Votuesve të Rinj për Zgjedhje". Ky projekt ka synuar vënien e kontakteve të drejtpërdrejta me të rinjtë lidhur me të drejtën e votës dhe rëndësinë që ka vota e tyre.

Po ashtu, qëllimi i këtij projekti ka qenë informimi dhe edukimi, përkatësisht vetëdijësimi i të rinjëve të cilët i kanë mbushur 18 vjet, ose deri në zgjedhjet e ardhshme do t'i mbushin 18 vjet, lidhur me rolin që mund të luajnë në përmirësimin e jetës, duke marrë pjesë aktive në procesin zgjedhor.

Përmes këtij projekti janë arritur disa objektiva që kanë të bëjnë me informimin dhe edukimin e votuesve, edukimin dhe vetëdijësimin e të rinjëve për të drejtën e tyre për të votuar, rëndësinë

e votës së tyre në zhvillimin e demokracisë, sistemin dhe procedurat zgjedhore (si të votohet), si dhe nxitja dhe mobilizimi i tyre për pjesëmarrje sa më të madhe në zgjedhje.

Përmbushja e këtyre objektivave është arritur përmes organizimit të ligjëratave, diskutimeve dhe shpërndarjes së rreth 30 mijë fletushkave informuesve. Ligjëratat janë mbajtur në të gjitha shkollat e mesme të Kosovës, pa dallim përkatësie etnike, në bazë të specifikave gjuhësore.

Përfituesit direkt nga ky projekt janë rreth 30 mijë nxënës (maturant) të shkollave të mesme, si votues për herë të parë. Partnerët për realizimin e këtij projekti kanë qenë Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknoligjisë, Drejtoritë Komunale të Arsimit dhe Drejtorët e Shkollave të Mesme.

#### *5.1.5.2. Dita Globale e Zgjedhjeve*

Komisioni Qendor i Zgjedhjeve ka organizuar për herë të katërt shënimin e Ditës Globale të Zgjedhjeve, e cila shënohet në mbarë botën çdo të enjte të parë të muajit shkurt.
Shënimi i kësaj ngjarjeje është e një rëndësie të veçantë për KQZ-në për të promovuar mesazhe pozitive duke pasqyruar funksionin dhe përgjegjësinë për organizimin dhe implementimin e zgjedhjeve në Kosovë.

Gjithashtu, shënimi i kësaj ngjarjeje, kontribuon tek qytetarët në promovimin e vlerave dhe rëndësinë e KQZ-së si kateogori kushtetuese në sigurimin e udhëzimeve të qarta drejt vizionit në rritjen e kapaciteteve dhe nivelit të organizimit të zgjedhjeve.

Kjo ditë u shënua (kësaj radhe) më 4 shkurt, ku Zyrtarët e Lartë Komunal të Zgjedhjeve, nga secila komunë, mbajtën takime/ligjeratë me përfaqësues të të rinjëve dhe me përfaqësues të maturantëve për temën *Rëndësia e pjesëmarrjes së të rinjëve në zgjedhje*.
Po ashtu, me rastin e shënimit të kësaj dite, me qëllim të informimit të të rinjëve, është bërë shpërndarja e 3 mijë fletëpalosjeve me informacione për zgjedhjet.

### *5.1.6. Vendimet dhe mbledhjet e KQZ-së*

Gjatë vitit 2016, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka mbajtur 45 mbledhje dhe ka marrë gjithsejtë 104 vendime.

## 5.2. Bashkëpunimi brenda – jashtë vendit dhe vëzhgimi i zgjedhjeve

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka shënuar sukses të jashtëzakonshëm në vitin 2016. Pas anëtarësimit në Asociacionin e Trupave Zgjedhore Botërore (A-WEB) në 2013, KQZ ka arritur që të bëhet anëtari i 25'të me të drejta të plota i Asociacionit të Zyrtarëve Zgjedhor Europian (ACEEEO) në shtator 2016.

Gjithashtu, gjatë këtij viti Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vëzhguar zgjedhje në disa vende, me qëllim të rritjes së bashkëpunimit me institucione të menaxhimit të zgjedhjeve dhe me qëllim të shkëmbimit të përvojave në fushën e zgjedhjeve.

Bashkëpunimi edhe brenda vendit, me institucione tjera, ka shënuar rezultate konkrete.

### *5.2.1. Anëtarësimi i KQZ-së në ACEEEO*

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është anëtarësuar në Asociacionin e Zyrtarëve Zgjedhor Europian me të drejtë të plota, duke u bërë anëtari i 25'të i këtij Asociacioni.

Ky vendim është marrë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të ACEEEO-s, mbajtur në Tiranë më 21 shtator 2016 Për anëtarësimin e KQZ-së në ACEEEO votuan shumica e përfaqësuesve të pranishëm në këtë mbledhje.

Asociacioni i Zyrtarëve Zgjedhor Europian (ACEEEO) promovon institucionalizimin dhe profesionalizimin e procedurave demokratike në regjion, si një organizatë regjionale jo fitimprurëse, që është e pavarur nga partitë politike dhe qeveritë, me status ligjor të bazuar në të drejtën ndërkombëtare.

#### *5.2.1.1. KQZ dhe ACEEEO me Memorandum Bashkëpunimi*

Disa muaj para anëtarësimit me të drejta të plota në ACEEEO, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kanë nënshkruar Memorandumin e Bashkëpunimit me ACEEEO-n, përmes së cilit vazhdohet bashkëpunimi i implementuar brenda kornizës së mëparshme.

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje aktuale është që KQZ-ja të marrë pjesë në programet e shkëmbimit dhe projektet, konsultimet, bashkëpunimin dhe përkrahjen teknike të organizuar nga ACEEEO, në çështje që lidhem me administrimin e zgjedhjeve.

Për të përmbushur qëllimin e kësaj Marrëveshjeje, do të ndërmerren aktivitete të ndryshme:

- ✓ *Promovimi i rritjes së mundësive të shkëmbimit në mes të autoriteteve zgjedhroe të ACEEEO-s dhe KQZ-së;*
- ✓ *Organizimi i përbashkët i ngjarjeve ndërkombëtare në temat me interes të përbashkët; dhe*
- ✓ *Shkëmbimi i informatave, dokumenteve, publikimeve dhe legjislacionit zgjedhor.*

#### *5.2.1.2. Vizita e KQZ-së së Shqipërisë pas anëtarësimit në ACEEEO*

Pak kohë pas anëtarësimit të KQZ-së së Kosovës në Asociacionin e Zyrtarëve Zgjedhorë Europian (ACEEEO) një delegacion i KQZ-së së Shqipërisë qëndroi për vizitë në institucionin tonë. Gjatë këtij takimi, kryetarja e KQZ-së, znj. Daka shprehu falënderim për KQZ-në e Shqipërisë për mbështetjen e madhe që ka dhënë për anëtarësimin e KQZ-së së Kosovës në

ACEEEO. Më tej, anëtarët e të dy institucioneve u dakorduan për thellim të bashkëpunimit dhe se mund të përfitohet nga përvojat gjatë proceseve zgjedhore në të dy vendet.

### *5.2.2. <Gratë në menaxhimin zgjedhor>*

Gjatë Konferencës së 25-të Ndërkombëtare të ACEEEO-s, që u mbajt në Tiranë, është lansuar edhe organizata ndërkombëtare *Gratë në Menaxhimin Zgjedhor.*

Qëllimi dhe objektivat e kësaj organizate janë ngritja e kapaciteteve të Trupave Zgjedhore për çështjet gjinore përmes krijimit të një rrjeti bashkëpunimi që do të realizojë studime të bazuara në kërkime dhe statistika gjinore; të shkëmbejë eksperienca veçanërisht të grave të angazhuara në nivele të larta të administrimit zgjedhor; zhvillimin e projekteve dhe programeve të ndryshme mbi edukimin zgjedhor të qytetarëve.

### *5.2.3. KQZ-ja zgjedhet anëtare e Komitetit të Auditimit dhe Mbikëqyrjes të A-ËEB'it*

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është zgjedhur anëtar i Komitetit të Auditimit dhe Mbikëqyrjes së Asociacionit të Zyrtarëve Zgjedhorë Botëror (A-WEB).

Ky vendim është marrë në takimin e 4-të të Bordit Ekzekutiv të këtij asociacioni që u mbajt në Neë Delhi, nga 21 – 24 shkurt 2016. Bordi Ekzekutiv është një strukturë mjaftë e rëndësishme dhe garanton përfaqësim të balancuar të të gjithë kontinenteve.

### *5.2.4. Memorandum Bashkëpunimi: KQZ – PZAP – PK – PSh – KGjK*

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe institucionet tjera si: Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, Polsicia e Kosovës, Prokuroria e Shtetit dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës kanë nënshkruar Memorandumin e Bashkëpunimit për procesin zgjedhor.

Qëllimi i këtij Memorandumi është ngritja e nivelit të bashkëpunimit dhe koordinimit të vazhdueshëm institucional në mes të KQZ-së, PZAP-së, PK-së, PSh-së dhe KGjK-së, për parandalimin e shkeljeve ligjore si dhe hetimin, ndjekjen dhe gjykimin efikas të të gjitha rasteve që bien ndesh me ligjet, rregullat zgjedhore apo veprat penale kundër të drejtave të njeriut në të gjitha fazat e procesit zgjedhor. Arritja e këtij Memorandumi për procesin zgjedhor në mes të institucioneve që merren me administrimin e zgjedhjeve është një nga disa aktivitetet që D4D ka zhvilluar në kuadër të projektit për drejtësinë zgjedhore të mbështetur nga Departamenti Federal për Punë të Jashtë të Zvicrës (FDFA).

### *5.2.5. Grupi për Qasje në Zgjedhje*

Me mbështetjen e IFES-it dhe të USAID-it, Grupi për Qasje në Zgjedhje ka vazhduar me mbajtjen e takimeve edhe gjatë vitit 2016.

Qëllimi i këtij grupi është që të sigurohet një barazi e plotë e personave me aftësi të kufizuara në proceset zgjedhore dhe jetën publike në përgjithësi. Grupi përbëhet nga deputetë të

Kuvendit të Kosovës, anëtarë të KQZ-së, përfaqësues nga PZAP, MPMS, MASHT, Handikos, Shoqata e të Verbërve të Kosovës, Shoqata Kosovare e të Shurdhërve dhe Shoqata Doën Syndrome Kosova.

### *5.2.6. Aktivitetet me Kuvendet Komunale*

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në bashkëpunim me OSBE ka organizuar punëtori lidhur me zëvendësimin e anëtarëve të Kuvendeve Komunale. Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur 6 punëtori me të gjithë përfaqësuesit e Kuvendeve Komunale në Republikën e Kosovës. Organizimi i punëtorive është zhvilluar nëpër qendrat më të mëdha.

### *5.2.7. Pjesëmarrja në konferenca dhe vëzhgimi i zgjedhjeve*

Gjatë këtij viti, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka marrë pjesë në konferenca të ndryshme ndërkombëtare dhe në vëzhgim të zgjedhjeve.

#### *5.2.7.1. Pjesëmarrja në Konferenca Ndërkombëtare*

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mori pjesë në Konferencën e 25 vjetore të ACEEEO-s, e organizuar nga KQZ-ja e Republikës së Shqipërisë. Pjesëmarrës në këtë konferencë ishin zyrtarë zgjedhorë nga rreth 40 vende të botës. Në këtë Konferencë u ofrua një panoramë e përgjithshme në lidhje me pjesët dhe ecuritë thelbësore të zgjedhjeve që nga themelimi i ACEEEO-s, si dhe u paraqitën zhvillimet e teknologjisë së zgjedhjeve në 25 vitet e fundit. Kjo Konferencë u përmbyll edhe me nënshkrimin nga kryetarja e KQZ-së, znj. Valdete Daka të Deklaratës së Pranimit të KQZ-së së Kosovës në këtë asociacion.

Po ashtu, KQZ ishte pjesë e Konferencës së 13 Europiane për Trupat Menaxhuese Zgjedhore të organizuar nga Komisioni i Venedikut i Këshillit të Europës, të mbajtur në Rumani; Konferencës së Asociacionit Ndërkombëtar të Nëpunësve, Regjistruesve, Zyrtarëve Zgjedhor dhe Financierëve të mbajtur në Memfis, Tenessee, ShBA; dhe në Konferencën E-Vote ID që u mbajt nën përkujdesjen e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, Thorbjorn Jagland.

#### *5.2.7.2 Vëzhgimi i Zgjedhjeve*

Një delegacion i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, i përbërë nga dy anëtarë, mori pjesë në Programin Zgjedhor të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (USEP) për vitin 2016, i cili këtë vit u pasua nga Konferenca e Shtatë Globale e Organizatave Zgjedhore (GEO – 7, e cila përmbajti diskutime teknike me interes të administratorëve të zgjedhjeve dhe u përqendrua në përdorimin e të dhënave dhe teknologjisë për të përmirësuar transparencën dhe llogaridhënien). Në Ditën e Zgjedhjeve, delegacioni i KQZ-së dhe pjesëmarrësit tjerë të Programit Zgjedhor morën pjesë në një turne të veçantë në vende të ndryshme, si në Ëashington, Maryland dhe Virgina, ndërsa në mbrëmje përcjellën së bashku transmetimin e drejtpërdrejtë të rezultateve të zgjedhjeve për President të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Po në këtë vit, një delegacion i KQZ-së, në përbërje të dy anëtarëve, mori pjesë në vëzhgimin e zgjedhjeve të shumëfishta që u mbajtën në Republikën Domenikane. Delegacioni i KQZ-së ishte pjesë e Misionit Vëzhgues Zgjedhor Ndërkombëtar i formuar nga disa vende anëtarë të Asociacionit të Trupave Zgjedhore Botërore (A-WEB), pjesë e së cilit është edhe KQZ-ja e Republikës së Kosovës. Gjatë qëndrimit në këtë vend, Misioni Vëzhgues Zgjedhor Ndërkombëtar janë pritur në takim drejtues të institucioneve që merren me organizimin e zgjedhjeve si dhe nga Presidenti i Republikës Domenikane, Danilo Medina Sanchez.
Gjithashtu, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në kuadër të bashkëpunimit të përhershëm që ka me institucionet nga vendet e rajonit mori pjesë në vëzhgimin e zgjedhjeve, si në Mal të Zi, Maqedoni dhe Bullgari, me qëllim të shkëmbimit të përvojave në fushën e zgjedhjeve.

## 5.3. Organizimi i Zgjedhjeve të Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Gllogocit

Pas shpalljes së Zgjedhjeve të Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Gllogocit nga Presidenti i Republikës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka filluar me përgatitjet për organizimin e këtij procesi zgjedhor. Në këtë drejtim janë ndërmarrë dhjetëra aktivitete.

### *5.3.1. Miratimi i Planit Operacional*

Në mbledhjen e mbajtur menjëherë pas shpalljes së datës së zgjedhjeve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve miratoi Planin Operacional për organizimin e këtyre zgjedhjeve, si dhe caktoi Aktivitetet kryesore zgjedhore.

### *5.3.2. Certifikimi i Subjekteve Politike dhe Kandidatëve*

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka certifikuar tetë (8) Subjekte Politike për pjesëmarrje në Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Gllogocit, pesë (5) prej tyre ishin Parti Politike dhe tre (3) Kandidatë të Pavarur.

| Akronimi | Emri i Subjektit Politik | Lloji i Subjektit Politik | Kandidatët |
|---|---|---|---|
| | Rrahim Elshani | Kandidat i Pavarur | RRAHIM ELSHANI |
| **NISMA** | Nisma për Kosovën | Parti Politike | ISA XHEMAJLAJ |
| **AKR** | Aleanca Kosova e Re | Parti Politike | ELMI THAÇI |
| | Xhavit Drenori | Kandidat i Pavarur | XHAVIT DRENORI |
| | Naim Bazaj | Kandidat i Pavarur | NAIM BAZAJ |
| | Fjala | Parti Politike | VEHBI BERISHA |
| **PDK** | Partia Demokratike e Kosovës | Parti Politike | RAMIZ LLADROVCI |
| **LDK** | Lidhja Demokratike e Kosovës | Parti Politike | BEDRI NIKA |

***Tabela 14**: Subjektet Politike të certifikuara për pjesëmarrje në zgjedhje (Gllogoc)*

### *5.3.3. Kufizimi i shpenzimeve dhe raportimi financiar i fushatës zgjedhore*

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve më 8 nëntor 2016 kufzoi shpenzimet e fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Gllogoc duke u mbështetur në numrin e votuesve sipas Listës Preleminare të Regjistrit Qendror Civil. Sipas këtij Regjistri numri i votuesve të regjistruar ishte 52 mijë e 963. Sipas vendimit të KQZ-së, shuma e mjeteve për shpenzimet e fushatës zgjedhore ishte 26 mijë e 481 euro e 50 cent.

Ndërkaq, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka pranuar nga subjektet politike raportet financiare të shpenzimeve të fushatës zgjedhore brenda afatit të përcaktuar ligjor.

### *5.3.4. Lista Përfundimtare e Votuesve*

Lista Përfundimtare e Votuesve për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Gllogocit është e bazuar në Ekstraktin e Regjistrit Qendror Civil.

Kjo listë ka përmbajtur 52 mijë e 569 emra të votuesve, me një rritje prej 2 mijë e 338 votues, apo 4.45% më shumë krahasuar me zgjedhjet e fundit për të njëjtën komunë.

Gjithashtu, në përmbushje të detyrimit ligjor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka mundësuar edhe *Periudhën e Votimit Jashtë Kosovës.* Periudha e Aplikimit për Regjistrim është ndërmarrë në mes të datës 9 nëntor dhe 17 nëntor 2016.

KQZ-ja ka dërguar 43 aplikacione për regjistrim votuesve që në zgjedhjet e fundit (2014) kishin arritur të dështmonin kriteret e zotësisë juridike për të votuar, e të cilët kanë qenë nga Komuna e Gllogocit. Informatat dhe formularët për regjistrim janë publikuar në ueb-faqen e KQZ-së. Gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur asnjë kërkesë për aplikim.

### *5.3.5. Informimi publik për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Gllogoc*

Pas shpalljes së Zgjedhjeve të Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Gllogocit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka miratuar Strategjinë e Informimit Publik, qëllimi i së cilës ka qenë që të arrijë t'i infomojë votuesit e kësaj komune për procesin zgjedhor, funksionimin e tij dhe të drejtat e tyre.

Përmes informimit, KQZ-ja ka synuar të arrijë disa objektiva, siç janë:

- *informimi i votuesve dhe Subjekteve Politike për procesin zgjedhor;*
- *informimi e votuesve për të drejtën e tyre për të cotuar;*
- *informim për mënyrën e votimit;*
- *inkurajimi për pjesëmarrje në zgjedhje;*
- *informim të saktë me qëllim të zvogëlimit të numrit të fletëvotimeve të pavlefshme;*
- *informimin për vendvotimin dhe ditën e votimit.*

Gjithashtu, gjatë zbatimit të kësaj strategjie, votuesit, përmes mediave të ndryshme, janë informuar për të gjitha fazat e procesit zgjedhor.

Lidhur me zbatimin e Strategjisë për Informim, KQZ-ja ka formuar një Këshill Mbikëqyrës, i cili ka informuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për ecurinë e zbatimit të saj, si dhe komisione të brendshme në përbërje të stafit të Sekretariatit.

### *5.3.6. Emërimi i KKZ-ve dhe KVV-ve*

Në kuadër të organizimit të këtyre zgjedhjeve Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka emëruar në afatin e paraparë Komisionin Komunal të Zgjedhjeve; Anëtarët e Këshillave të Vendvotimeve; Anëtarët e Këshillave të Vendvotimeve – Ekipet Mobile Lëvizëse; dhe stafin teknik për Qendrat e Votimit. Ndërsa, në raundin e dytë, pjesa dërmuese e tyre ishin të angazhuar edhe në raundin e parë.

| RAUNDI I PARË / 4 DHJETOR 2016 | RAUNDI I DYTË / 18 DHJETOR 2016 |
|---|---|
| 5 anëtarë të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) | 5 anëtarë të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) |
| 398 anëtarë të Këshillave të Vendvotimeve (KVV) | 391 anëtarë të Këshillave të Vendvotimeve (KVV) |
| 15 anëtarë të Këshillave të Vendvotimeve – Ekipet Mobile Lëvizëse | 15 anëtarë të Këshillave të Vendvotimeve – Ekipet Mobile Lëvizëse |
| 168 persona si staf teknik për Qendrat e Votimit | 168 persona si staf teknik për Qendrat e Votimit |

***Tabela 15:*** *Emërimi i KKZ-ve dhe KVV-ve për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Gllogoc*

### *5.3.7. Trajnimi i trupave zgjedhore për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Gllogoc*

Duke u mbështetur në Planin Operacional të miratuar nga KQZ-ja, janë përmbushur detyrimet që kanë të bëjnë me trajnimin profesional të trupave zgjedhore. Për raundin e parë dhe të dytë janë mbajtur seanca të trajnimit të qindra personave, si në vijim:

- *Trajnimi i trajnerëve për procedurat e votimit dhe numërimitl;*
- *Trajnimi i Komisionit Komunal të Zgjedhjeve;*
- *Trajnimi i trajnerëve të KKZ-së;*
- *Trajnimi i trajnerëve të Këshillave të Vendvotimit;*
- *Trajnimi i Ekipeve Mobile për procedurat për votimin e Personave me Nevoja të Veçanta;*
- *Trajnimi i Këshillave të Vendvotimit;* dhe
- *Trajnimi i Kryesuesve të Këshillave të Vendvotimit.*

### *5.3.8. Akreditimi i Vëzhguesve*

Me qëllim të vëzhgimit të procesit zgjedhor në Komunën e Gllogocit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka akredituar më shumë se një mijë vëzhgues, në të dy raundet.

| Raundi i pare 1 dhjetor 2016 | | Raundi i dytë 18 dhjetor 2016 | |
|---|---|---|---|
| **Llojet e subjekteve politike dhe organizatave të akredituara** | **Numri i akredituar i vëzhguesve** | **Llojet e subjekteve politike dhe organizatave të akredituara** | **Numri i akredituar i vëzhguesve** |
| **4 Parti Politike** | 506 | **4 Parti Politike** | 145 |
| **1 Kandidat i Pavarur** | 18 | **1 Ambasadë** | 2 |
| **1 Ambasadë** | 6 | **3 Organizata Ndërkombëtare** | 13 |
| **3 Organizata Ndërkombëtare** | 43 | **4 OJQ Lokale** | 54 |
| **4 OJQ Lokale** | 207 | **14 Media** | 6 |
| **14 Media** | 73 | | |
| **Total:** | **853** | **Total:** | **220** |

***Tabela 16:*** *Numri i përgjithshëm i vëzhguesve të akredituar për vëzhgimin e Zgjedhjeve në Gllogoc*

### *5.3.9. Dita e Zgjedhjeve*

***Raundi i Parë (4 dhjetor 2016) –*** Pas përgatitjeve një mujore të bëra nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  të gjitha Vendvotimet u hapën me kohë, sipas planifikimeve. Procesi zgjedhor është zhvilluar normalisht dhe pa probleme.

Në bazë të Rezultateve Përfundimtare përqindja e pjesëmarrjes në zgjedhje ishte: 41.21%. Asnjëri nga kandidatët nuk arriti të siguronte numrin e kërkuar të votave për t'u shpallur fitues në këtë raund.

***Raundi i Dytë (18 dhjetor 2016) –*** Edhe këtë radhë procesi zgjedhor u zhvillua normalisht dhe KQZ-ja arriti ta përmbyllë suksesshëm këtë organizim.

### *5.3.10. Numërimi, tabulimi dhe publikimi i rezultateve*

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka certifikuar Rezultatet Përfundimtare të këtyre zgjedhjeve (raundi i parë) më 8 dhjetor 2016 dhe më 23 dhjetor 2016 (raundi i dytë). Sipas këtyre rezultateve, Kryetar i Komunës së Gllogocit është zgjedhur z. Ramiz Lladrovci nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me 14 mijë e 537 vota apo 62.55%.

| REZULTATET PËRFUNDIMTARE | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| RAUNDI I PARË | | | | RAUNDI I DYTË | |
| **Emri / Ime** | **Mbiemri / Prezime** | **Vota / Glasova** | **Përqindja / Procenat** | **Vota / Glasova** | **Përqindja / Procenat** |
| **RAMIZ** | **LLADROVCI** | **9 458** | **45.34%** | **14 537** | **62.55%** |
| **ISA** | **XHEMAJLAJ** | **5 462** | **26.19%** | **8 704** | **37.45%** |
| XHAVIT | DRENORI | 2 633 | 12.62% | | |
| ELMI | THAÇI | 1 589 | 7.62% | | |
| BEDRI | NIKA | 1 113 | 5.34% | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| VEHBI | BERISHA | 567 | 2.72% | |
| NAIM | BAZAJ | 27 | 0.13% | |
| RRAHIM | ELSHANI | 9 | 0.04% | |

***Tabela 17:*** *Rezultatet Përfundimtare të të dy raundeve të zgjedhjeve për Kryetar të Komunës së Gllogocit*

#### *5.3.10.1. Publikimi i Rezultateve Preleminare (K – Vote)*

Nisur nga suksesi i publikimit të rezultateve preleminare përmes sistemit K – Vote në vitin 2013 dhe 2014, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vendosur që edhe për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Gllogoc të bëjë *Raportimin e numërimit preleminar* në mënyrë të njëjtë. Ky projekt ka mundësuar grumbullimin e të dhënave, tabulimin dhe transmetimin e drejtpërdrejtë të Rezultateve Preleminare në ëeb faqe të KQZ-së pas përfundimit të procesit të votimit dhe të të gjitha procedurave të numërimit të fletëvotimeve nga 72 Vendvotime, më 4 dhe 18 dhjetor 2016.

#### *5.3.10.2. Audienca dhe shikueshmëria e ueb faqes së rezultateve*

Nga dita kur është bërë lansimi online i ueb faqes së rezultateve (3 dhjetor) e deri më 19 dhjetor, ueb faqja është shfletuar 291 mijë e 124 herë, nga 73 mijë e 762 vizitorë unik, nga më shumë se 20 shtete.

| Shteti | Përqindja e vizitave |
|---|---|
| **Kosova** | 90.08 % |
| **Gjermania** | 2.09 % |
| **Zvicra** | 1.88 % |
| **Suedia** | 0.53 % |
| **Austria** | 0.51 % |
| **Mbretëria e Bashkuar** | 0.43 % |
| **Maqedonia** | 0.32 % |
| **Shqipëria** | 0.25 % |
| **Italia** | 0.23 % |
| **Franca** | 0.22 % |
| **Shtetet tjera** | 3 % |

***Tabela 18:*** *Audienca sipas shteteve*

# 6. BUXHETI DHE FINANCAT

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është organizatë buxhetore, me kod organizativ 320. KQZ-ja financohet nga Buxheti i Kosovës. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është i organizuar ne tri programe buxhetore:

- *14100 Programi i Sekretariatit te KQZ-së, i cili paraqet shpenzimet operacionale;*
- *14200 Programi i Zgjedhjeve, i cili paraqet buxhetin e zgjedhjeve;*
- *10400 Programi  Fondi për mbështetje demokratike.*

## 6.1. Aprovimi i buxhetit

Me ligjin e Buxhetit te Kosovës, Ligji Nr. 05/L-071 për vitin 2016, KQZ-së i është aprovuar Buxheti për tri  programet në shumë prej **5,439,152 euro** si dhe numri i aprovuar i stafit me këtë ligj ishte 88 zyrtarë.

Ne kuadër të këtij buxheti është aprovuar buxheti për tri programet e KQZ-se si ne vijim:

- Programi, Sekretariati ne shume prej  1,176,222.00 Euro,
- Programi, Zgjedhjet ne shume prej 62,930.00 Euro,
- Programi, Fondi për mbështetje demokratike ne shume prej 4,200,000.00 euro.

## 6.2. Rishikimi i buxhetit

Me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016,  KQZ-së i është aprovuar  Buxheti për tri  programet në shumë prej **5,428,652 euro** si dhe numri i aprovuar i stafit me këtë ligj ishte 88 zyrtarë.
Ne kuadër të këtij buxheti është aprovuar buxheti për tri programet e KQZ-se si ne vijim:

- Programi, Sekretariati ne shume prej  1,145,722.00 euro,
- Programi, Zgjedhjet ne shume prej 82,930.00 euro,
- Programi, Fondi për mbështetje demokratike ne shume prej 4,200,000.00 euro.

- Në total buxheti i KQZ-se eshte zvogluar prej 10,500.00 euro me rishikim te buxhetit.

Ndërsa sipas programeve buxheti me rishikim per KQZ-ne eshte si ne vijim:

- Ne programin e Sekretariatit buxheti eshte zvogëluar ne shume  prej 30,500.00 euro,
- Ne programin e Zgjedhjet buxheti eshte shtuar prej 20,000.00 euro.

## 6.3. Buxheti shtesë

Me vendim nr. 08/115 të datës 09.11.2016 të Kryeministrit të Republikes se Kosovës KQZ-së për organizim të Zgjedhjeve të Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Gllogocit i janë ndarë mjete shtesë si në vijim:

- Programin e Sekretariatit te KQZ-se, kategoria ekonomke, Paga dhe meditje në shumën prej 12,544.00 euro;
- Programin e Zgjedhjeve të KQZ-së, kategoria ekonomike, Mallëra dhe shërbime në shumën prej 209,000.00 euro.

Me vendim nr. 01/123 të datës 28.12.2016 të Kryeministrit të Republikes se Kosovës, KQZ-se ju eshte shkrtuar buxheti ne shume prej 252,349.60€ sipas ketyre kategorive ekonomike dhe programeve:

- Nga kategoria e mallra dhe shërbime është shkurtuar buxheti në shumë prej 235,556.77 euro. Nga programi i Sekretariatit është shkurtuar për 159,194.71€ dhe nga programi i zgjedhejve për 76,362.06 euro.
- Nga kategoria e e shpenzimeve Komunale është shkurtuar buxheti në shumë prej 15,238.33€, ku prej kesaj shume nga programi i Sekretariatit është marrë buxheti në shumë prej 14,403.90€ dhe nga programi i Zgjedhjeve shuma prej 834,43€.
- Nga kategoria e Shpenzimeve kapitale është shkurtuar buxheti në shumë prej 105.00€ kjo shume i perket programit te Zgjedhejve.
- Nga kategoria e Subvencioneve dhe Transfereve është shkurtuar buxheti në shumë prej 1,449.50€.

Buxheti i planifikuar i KQZ-së për vitin 2016 ishte në shumë prej 5,439,152.00 Buxheti përfundimtar për vitin 2016 ishte 5,397,846.40 euro dhe ka këtë strukturë buxhetore:

- 0.140 % të fondeve janë akorduar për mbulimin e shpenzimeve për paga dhe mëditje,
- 0.076% të fondeve është akorduar për shpenzime mallra dhe shërbime,
- 0.778% te fondeve për subvencione dhe transfere,
- 0.004% për shpenzimet komunale dhe
- 0.002% të fondit për shpenzime kapitale.

| Kategoritë ekonomike | Buxheti Fillestar | Buxheti Përfundimtar | Buxheti i Shpenzuar | % Buxheti i shpenzuar |
|---|---|---|---|---|
| **Paga dhe Mëditje** | 744,492.00 | 757,036.00 | 756,383.88 | 99.91% |
| **Mallra &Shërbime** | 436,269.00 | 409,712.23 | 381,569.65 | 93.13% |
| **Shpenzimet Komunale** | 48,391.00 | 22,652.67 | 22,643.55 | 99.96% |
| **Subvencione dhe transfere** | 4,200,000.00 | 4,198,550.50 | 4,198,550.50 | 100.00% |
| **Shpenzimet Kapitale** | 10,000.00 | 9,895.00 | 9,895.00 | 100.00% |
| **Totali** | **5,439,152.00** | **5,397,846.40** | **5,369,042.58** | **99,47%** |

***Tabela 19:*** *Buxheti i planifikuar dhe shpenzuar për periudhën janar – dhjetor 2016*

Në këtë vit, KQZ-ja ka shpenzuar 5,369,042.58 euro të buxhetit, apo 99,47%. Shprehur në përqindje, sipas kategorive ekonomike KQZ-ja ka shpenzuar buxhetin me këtë strukturë:

- në kategorinë e pagave dhe mëditjeve buxheti i planifikuar u shpenzua 99.91%,
- në mallra dhe shërbime buxheti i planifikuar u shpenzua 93,13%,
- në shpenzimet komunale buxheti i planifikuar u 99,96%,
- shpenzimet subvencione dhe transfere buxheti i planifikuar u shpenzua 100.00% dhe
- buxheti i planifikuar për shpenzime kapitale u shpenzua 100.00%.

Menaxhimi i buxhetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është realizuar me korrektësi sipas zërave të shpenzimeve dhe me efektivitet, duke treguar kujdes që fondet e miratuara të shpenzohen sipas planit, në kohën e duhur dhe me një administrim ekonomik efektiv.




***Figura 1:*** *Paraqitja grafike e buxhetit të planifikuar dhe shpenzuar për vitin 2016.*

### 6.4. Paga dhe mëditje

Sipas buxhetit të aprovuar për vitin 2016, KQZ-ja ka 88 zyrtarë të aprovuar prej të cilëve 11 janë të KQZ-së dhe 77 shërbyes civil të Sekretariatit të KQZ-së, prej të cilëve 38 zyrtarë janë në komuna të Kosovës në pozitën e Zyrtarit të lartë komunal Zgjedhor.

Buxheti final në paga dhe mëditje për vitin 2016 ishte në shumën prej 757,036.00 euro.

Gjatë periudhës vitit 2016, buxheti në këtë kategori është shpenzuar në shumë prej 756,383.88 euro ose 99.91% e buxhetit të planifikuar.

### 6.5. Mallrat dhe shërbimet

Buxheti i aprovuar i KQZ-së sipas Ligji Nr. 05/L -071 të vitit 2016 ishte në shumë prej 436,269.00€. pas ndryshimeve të bëra me rishikim dhe vendime të Qeverisë, buxheti në mallra dhe shërbime është në shumën prej 409,712.23€. kjo shumë është shpenzuar për 93.13 % ose në vlerë totale prej 381,569.65 euro.

### 6.6. Shpenzimet komunale

Shpenzimet komunale janë planifikuar për programin e Sekretariatit KQZ-së dhe të Zgjedhjeve në vlere prej 48,391.00€, me rishikim te buxhetit kjo shumë është zvogëluar prej 10,500€ dhe me vendim te Qeveris eshte zvogeluar buxheti ne vler prej 15,238.33€ ku buxheti përfundimtar është 22,652.67 euro të cilat janë shpenzuar në vlerë prej 22,643.55€ ose 99.96%.

### 6.7. Subvencione dhe transfere

Me Ligjin Nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016 buxheti i aprovuar për programin Mbështetje e Subjekteve Politike(10400) ishte në shumën prej 4,200,000 euro. Me vendim te Qeveris buxheti eshte zvogluar ne shume prej 1,449.50€ dhe buxheti prefundimtar ne fund eshte 4,198,550.50€. Gjatë vitit 2016 subjektet politike nga buxheti subvencioneve kanë shpenzuar buxhetin në shumën prej 4,198,550.50 euro apo buxhetin i planifikuar është shpenzuar 100.00%.

| NR. | KODI PROGRAMIT | SUBJEKTE POLITIKE | NR.VENDEVE MANDATI I RI | PLANIFIKIMI I BUXHETIT | SHUMA E PAGUAR | % E REALIZIMIT |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 10402 | PDK | 37 | 1,165,500.00 | 1,165,500.00 | 100% |
| 2 | 10401 | LDK | 30 | 945,000.00 | 945,000.00 | 100% |
| 3 | 10427 | VETVENDOSJE | 16 | 504,000.00 | 504,000.00 | 100% |
| 4 | 10403 | AAK | 11 | 346,500.00 | 346,500.00 | 100% |
| 5 | 10432 | SRPSKA LISTA | 9 | 283,500.00 | 283,500.00 | 100% |
| 6 | 10433 | NISMA | 6 | 189,000.00 | 189,000.00 | 100% |
| 7 | 10407 | KDTP | 2 | 63,000.00 | 63,000.00 | 100% |
| 8 | 10406 | VAKAT | 2 | 63,000.00 | 63,000.00 | 100% |
| 9 | 10416 | PDAK | 1 | 31,500.00 | 31,500.00 | 100% |
| 10 | 10430 | PAI | 1 | 31,500.00 | 31,500.00 | 100% |
| 11 | 10431 | NDS | 1 | 31,500.00 | 31,500.00 | 100% |
| 12 | 10434 | PDS | 1 | 31,500.00 | 31,500.00 | 100% |
| 13 | 10435 | PLE | 1 | 31,500.00 | 31,500.00 | 100% |
| 14 | 10436 | KZA | 1 | 31,500.00 | 31,500.00 | 100% |
| 15 | 10437 | KNRP | 1 | 31,500.00 | 31,500.00 | 100% |
| | **Totali** | | **120** | **3,780,000.00** | **3,780,000.00** | **100%** |

***Tabela 20:*** *Buxheti i planifikuar për Subjektet Politike dhe shpërndarja për vitin 2016*

| NR. | KODI PROGRAMIT | GRUPI PARLAMENTAR | NR.VENDEVE MANDATI I RI | PLANIFIKIMI I BUXHETIT | SHUMA E PAGUAR | % E REALIZIMIT |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 10452 | PDK | 37 | 129,338.40 | 129,338.40 | 100% |
| 2 | 10451 | LDK | 30 | 104,873.74 | 104,873.74 | 100% |
| 3 | 10462 | VETVENDOSJE | 16 | 55,991.57 | 55,991.57 | 100% |
| 4 | 10453 | AAK | 11 | 38,490.01 | 38,490.01 | 100% |
| 5 | 10461 | 6+ | 6 | 20,989.89 | 20,989.89 | 100% |
| 6 | 10464 | SRPSKA LISTA | 9 | 31,415.45 | 31,415.45 | 100% |
| 7 | 10465 | NISMA | 6 | 20,940.19 | 20,940.19 | 100% |
| 8 | 10475 | PDS | 1 | 3,495.25 | 3,495.25 | 100% |
| 9 | 10476 | PAI | 1 | 2,625.00 | 2,625.00 | 100% |
| 10 | 10477 | NDS | 1 | 3,500.00 | 3,500.00 | 100% |
| 11 | 10472 | PLE | 1 | 3,489.00 | 3,489.00 | 100% |
| 12 | 10478 | KZA | 1 | 3,402.00 | 3,402.00 | 100% |
| **Totali** | | | **120** | **418,550.50** | **418,550.50** | **100%** |

***Tabela 21:*** *Buxheti i planifikuar për Grupet Parlamentare dhe pagesat për vitin 2016*

### 6.8. Shpenzimet kapitale

Me Ligjin Nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016 në këtë kategori është aprovuar buxhet në vlerë prej 10,000.00€, me vendim te Kryeministrit eshte shkurtuar buxheti ne shume prej 105.00€ dhe buxheti ne fund te vitit eshte 9,895.00€ Nga kjo kategori në këtë periudhë të nentëmujorit është shpenzuar shuma 9,895.00 euro ose 100.00%.

### 6.9. Të hyrat vetanake

